

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5793
E hënë, 3 qershor 2019
çmimi 0.40 €

Veseli thotë se tribunali
për gjenocidin serb
në Kosovë është
i domosdoshëm | FAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", NAIM TËRNAVA | FAQE 4-5

Liderët duhet të bashkohen për të ardhmen e vendit



Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), Naim Tërnavë, u ka bërë thirrje liderëve politikë të vendit që të bashkohen për interesat kombëtare të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se

ndasitë politike nuk duhet të vijnë në shprehje kur është në pyetje e ardhmja e Kosovës. Kreu i BIK-ut ka kërkuar nga institucionet e Kosovës që ta ndajnë një pjesë të buxhetit shtetëror për bashkësitë fetare. Sipas Tërnavës,

për BIK-un është mjaft sfiduese që t'i sigurojë çdo muaj pagat e 2 000 punëtorëve. Me rastin e Fitër Bajramit, myftiu Tërnavë ka bërë thirrje që të zgjatet dora e pajtimit dhe të ndërpriten armiqësitë

GAZETA "EPOKA E RE"
TË GJITHË
BESIMTARËVE
MYSLIMANË UA URON
FITËR BAJRAMIN!

OPINION

DËNIMI I
KRIMEVE TË
KOMUNIZMIT,
SFIDË PËR
KUVENDIN E
KOSOVËS | F.11



Nga: Ismet HAJRULLAHU

KUR GAZETARIA ONLINE
VIKTIMIZOHET NGA RRJETET
SOCIALE, CILAT JANË SFIDAT
E PROFESIONISTËVE? | F.11

Nga Musa
SABEDINI



EKONOMI

INDUSTRIA PRODHUESE
SHËNON RITJE TË LEHTË | F. 9



KULTURË

SË SHPEJTI DO TË FILLOJË
RESTAURIMI I KULLËS SË
PATRIOTIT RAMË BLLACA | F. 14



Analistët: Samiti i Parisit mund ta
vendosë bazamentin e marrëveshjes
finale Kosovë - Serbi | FAQE 3

Thaçi: Jam i pakënaqur me qëndrimin
e BE-së në raport me Kosovën | FAQE 3



RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhepçisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERAMBANK VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Stoltenberg: Dhuna politike bie ndesh me vlerat demokratike

"Dhuna politike bie ndesh me vlerat tona demokratike, prandaj është absolutisht e papranueshme sikundër dhe çdo përpjekje për t'i minuar institucionet demokratike", ka thënë, të dielën në Tiranë, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg

TIKANË, 2 QERSHOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, tha të dielën në Tiranë se dhuna politike bie ndesh me vlerat demokratike dhe është absolutisht e papranueshme. Komentet e tij lidhur me zhvillimet politike në vend, Stoltenbergu i bëri në përfundim të një takimi me kryeministrin Edi Rama. Ai iu drejtua me një thirrje forcave politike të sillen në mënyrë të përgjegjshme dhe me vetëpërmbytje dhe të zgjidhin çdo mosmarrëveshje. Ndërsa në mbrëmje opozita ka thirrur protestën e radhës para selisë së kryeministrisë, nga e njëjta godinë, pasdite, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens

Stoltenberg, bëri thirrje për dialog mes aktorëve politikë, duke theksuar se dhuna politike është e papranueshme. Vizita e tij në Tiranë e njoftuar vetëm pak ditë më parë, i parapriu asaj në Shkup, e cila ishte planifikuar prej kohësh. Në një konferencë shtypi me kryeministrin Edi Rama, pas takimit që pati me të, Stoltenberg u ndal duke komentuar zhvillimet e fundit politike në Shqipëri, ndërsa vlerësoi më parë kontributin e vendit në NATO dhe shembullin, siç u shpreh ai, që Shqipëria jep për paqen dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor. "Në demokraci do të ketë gjithmonë debate e mendime të

ndryshme. Kjo nuk është dobësi, është në themel të asaj që e bën demokracinë të fortë. Por dhuna politike bie ndesh me vlerat tona demokratike. Është absolutisht e papranueshme sikundër dhe çdo përpjekje për t'i minuar institucionet demokratike", u shpreh sekretari i përgjithshëm i NATO-s. Ai u bëri thirrje "të gjithë aktorëve politikë të sillen në mënyrë të përgjegjshme dhe me vetëpërmbytje dhe ta tregojnë konsensusin e nevojshëm politik për ta vazhduar rrugën e integritetit dhe të zgjidhin çdo dallim përmes dialogut dhe proceseve politike, sepse një gjë e tillë kontribuon në një të ardhme më të mirë të Shqipërisë dhe të rajonit". Nga ana e tij, kryeministri Edi Rama tha se, sipas tij, protesta e opozitës nuk është shfaqje e një shqetësimi të madh popullor. "Është një inskenim politik dhe nuk ka shans të shtrihet përtej kufijve të skenës politike. Ne do t'i zhvillojmë zgjedhjet si një proces i patjetërsueshëm demokratik.

Nëse dikush nuk preferon dhe vendos të mos hyjë në zgjedhje, kjo nuk i bën zgjedhjet jodemokratike", tha ai. Kryeministri tha më tej se "nuk do të lejohet të ndodhë asnjë formë destabilizimi që do ta cenonte imazhin e vendit përtej atij që sjell organizimi i shfaqjeve të dhunshme në një perimetër të ngushtë dhe pa mbështetje", u shpreh kryeministri, ka njoftuar vova. Pak pas komenteve të sekretarit të përgjithshëm të NATO-s, Stoltenberg, mbi zhvillimet politike në Shqipëri, kryetari demokrat Lulzim Basha, duke ftuar qytetarët t'i bashkohen protestës, u shpreh përmes një postimi në "Facebook", se nuk do të ketë "asnjë hap pas për çlirim e vendit nga e keqja. Pushteti i kërkon ka rënë. Parlamenti është i paligjshëm. Fëmijët e shqiptarëve janë pa bukë. Shtëpitë po prishen për korrupsion. Drejtësia është e kapur! Biznesi po rrënohet! Dhuna godet kudo! Thika e pushtetit ka prekur palcën! Nuk

durohet më!", thekson Basha duke shtuar se "vetëm vota e lirë do të sjellë një qeveri që punon për njerëzit. Për mirëqenie. Për punësim. Për zhvillim. Vetëm standardet dhe demokracia do ta hapin rrugën tonë drejt Evropës."

Prania e NATO-s në Kosovë, thelbësore për sigurinë dhe paqen në rajon

Presidenti i Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta, ka prituri në takim sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, me të cilin ka biseduar për çështjen e sigurisë në vend dhe rajon, duke përfshirë edhe Kosovën. Pas takimit, Meta në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se prania e NATO-s në Kosovë, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e këtij shteti dhe Bashkimin Evropian, janë thelbësore për sigurinë dhe paqen në rajon. "Kënaqësi ta takoja sot sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, vizita e të cilit përkon me 10-vjetorin e anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, objektivin strategjik të të gjitha qeverive shqiptare të pas '90-s, të grave dhe burrave të Forcave tona të Armatosura dhe, mbi të gjitha, të të gjithë shqiptarëve. Do të vazhdoj ta inkurajoj rritjen e buxhetit për mbrojtjen në 2 % brenda 2024-s jo vetëm si detyrim, por edhe si përgjegjësi për ndarjen e barrës në shërbim të mbrojtjes kolektive, sepse është detyra dhe përgjegjësi e çdo aleati ta forcojmë Aleancën", tha Meta. "Prania e NATO-s në Kosovë, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e këtij shteti dhe Bashkimin Evropian, është thelbësore për sigurinë dhe paqen në rajon. Me Stoltenbergun ndava krenarinë për rolin jetik të shqiptarëve të Maqedonisë së Veriut për anëtarësimin e fqinjit tonë në NATO", ka shkruar Meta.



Zaevi dhe Ahmeti bisedojnë për "fshesën"

SHKUP, 2 QERSHOR - Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) ende mban të fsheshtë emrat e ministrave dhe zyrtarëve të tjerë që do të preken nga "fshesa" e Zaevit. Zëdhënësi i partisë, Bujar Osmani, tha se bisedimet për formatimin e qeverisë në mes të Zaevit dhe Ahmetit nuk janë finalizuar ende. Osmani vetëm tha se ndryshimet do të jenë konform synimit të ekzekutivit

për zhvillim ekonomik. "Fshesa nuk është parim të cilin BDI-ja e shfrytëzon. Megjithatë, kryetari Ahmeti dhe Zaevi flasin për përforcimin e kapaciteteve të qeverisë para hapjes së kapitullit të ri të fokusit të qeverisë dhe ajo është ekonomia", tha zëvendëskryeministri Bujar Osmani.

Nga ana tjetër, dy ditë më parë kryeministri Zoran Zaev deklaroi

se i ka caktuar emrat e ministrave të rinj dhe se është në kontakt të vazhdueshëm me ta, por nuk i zbardhi emrat e tyre. Ai tha se do t'i ndërrojë të gjithë funksionarët të cilët janë sjellë në mënyrë arrogante, që nuk kanë përmbyshur obligimet dhe për të cilët qytetarët kanë pasur reagime negative. Zaevi deklaroi se reformat në qeveri duhet që të bëhen deri në mes të muajit qershor.



Njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe analistët politikë e kanë komentuar në mënyra të ndryshme Samitin e Parisit që pritet të mbahet më 1 korrik në Francë

Analistët: Samiti i Parisit mund ta vendosë bazamentin e marrëveshjes finale Kosovë - Serbi

Samiti i Parisit pritet të sjellë dinamikë të re në procesin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, kështu kanë vlerësuar analistët politikë dhe njohësit e marrëdhënieve ndërkombëtare. Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë për "Epokën e re" se Samiti i Parisit do të jetë një pikë kthese nga dy shtetet për t'iu rikthyer tryezës së dialogut përmes së cilës do të synohet potencialisht arritja e një marrëveshjeje. Ndërsa profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka deklaruar se në Samitin e Parisit pritet të vendoset bazamenti i marrëveshjes përfundimtare ndërmjet dy vendeve

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka thënë se Samiti i Parisit do të jetë një pikë kthese nga dy shtetet për t'iu rikthyer tryezës së dialogut përmes së cilës do të synohet potencialisht arritja e një marrëveshjeje. "Takimi me Merkelin do t'i shërbejë Kosovës për ta përgatitur Samitin e Parisit, por edhe për ta adresuar agjendën e saj të integrimi evropiane, veçanërisht liberalizimin e vizave. Derisa nga Samiti i Francës besoi se do të jetë një pikë kthese nga dy shtetet për t'iu rikthyer tryezës së dialogut, përmes së cilës do të synohet potencialisht arritja e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht të obligueshme", ka deklaruar Kryeziu për gazetën "Epoka e re".

Edhe profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Ibrahim Gashi, pret që Samiti i Parisit të dalë me një itinerar konkret për rrjedhën e dialogut. Ai ka vlerësuar se pozicioni i largët i palëve dhe pafuqia e znj. Mogherini e detyruan ndërhyrjen gjermano-frënge për ta shpëtuar procesin e dialogut që kishte filluar të stërkeqej dhe largohej nga synimi i tij final, arritja e një marrëveshjeje ligjërisht të obligueshme për palët që i hap rrugë normalizimit dhe njohjes reciproke mes dy shteteve. "Mendoj

se Samiti i Berlinit është një impuls i ri dhe vëmendje e shtuar e dy vendeve më të fuqishme për procesin e dialogut. Pozicioni i largët i palëve dhe pafuqia e znj. Mogherini detyruan ndërhyrjen gjermano-frënge për ta shpëtuar procesin e dialogut që kishte filluar të stërkeqej dhe largohej nga synimi i tij final, arritja e një marrëveshje

ligjërisht të obligueshme për palët që i hap rrugë normalizimit dhe njohjes reciproke mes dy shteteve. Pres që Samiti i Parisit të dalë me një itinerar konkret për rrjedhën e dialogut", ka thënë Gashi për gazetën "Epoka e re".

Ndërsa profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka deklaruar për gazetën

"Epoka e re" se në Samitin e Parisit pritet të vendoset bazamenti i marrëveshjes përfundimtare ndërmjet dy vendeve. "Nëse kalohet sikur në Samitin e Berlinit, mendoj se gjërat do të jenë krejtësisht formale, por unë dua të besoj se vetë fakti i thirrjes së një samiti në mbështetje të samitit paraprak reflekton përkushtimin e vendeve kryesore të BE-së që të shkojmë kah gjetja e një zgjedhje konkrete. Në Paris do të flitet me terma më konkretë dhe besoj se do të vihet bazamenti i marrëveshjes përfundimtare Kosovë - Serbi", është shprehur Hoti duke shtuar se roli dhe pozita e ShBA-së është e pakontestueshme në këtë proces. "Kemi një proces

hibrid për çështjen e vazhdimin të dialogut. Në muajt e fundit, ndoshta për shkak të zbehjes së rolit të përfaqësueses së BE-së për politikë të jashtme, Federica Mogherini, stafetën e udhëheqjes së këtij procesi e kanë marrë Gjermania dhe Franca si dy shtete kryesore të BE-së. Por, vërtet është shqetësuese nëse ShBA-ja nuk është e përfshirë në këtë proces sepse historia jonë e re dhe e vjetër ka dëshmuar se asnjë marrëveshje substanciale nuk është arritur pa praninë dhe mbështetjen e ShBA-së. Edhe në këtë që po njihet si marrëveshje përfundimtare roli dhe pozita e ShBA-së është e pakontestueshme", ka deklaruar Hoti.



Khavit Drenori i bashkohet Lëvizjes Vetëvendosje



PRISHTINË, 2 QERSHOR (ER) - Politikani Khavit Drenori të dielën i është bashkuar Lëvizjes Vetëvendosje (LV). Aderimi i tij në këtë parti është mirëpritur nga lideri Albin Kurti, i cili ka thënë se Drenori do të sjellë më shumë dije dhe përvojë, energji dhe punë në Lëvizje Vetëvendosje. "Si politikan tejet aktiv e aktivist i shoqërisë civile, si njeri i pasionuar pas dijes dhe mësimdhënës i dashur për stu-

dentët, Khaviti na sjell më shumë dije dhe përvojë, energji dhe punë në Lëvizje", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".

Kuti ka bërë me dije se Drenori do ta vazhdojë luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar si aktivist i Lëvizjes Vetëvendosje. "Nga viti 2013 e deri më 2018 ishte asamblist në Kuvendin Komunal në Drenas. Luftën kundër korrupsionit,

krimit të organizuar dhe dukurive të tjera negative në shoqëri, të filluara në asamblenë komunale në Drenas dhe më pas të shprehura edhe përmes videoincizimeve të shkurtra në rrjetet sociale, do ta vazhdojë si aktivist i Lëvizjes Vetëvendosje", ka theksuar ai. Khavit Drenori ka doktoruar në Universitetin Evropian të Tiranës në drejtimin e Shkencave Sociale - Marrëdhëniet Ndërkombëtare.

Flet për "Epokën e re", Naim Tërnavë

Liderët duhet të bashkohen

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), Naim Tërnavë, u ka bërë thirrje liderëve politikë të vendit që të bashkohen për interesat kombëtare të Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ndasitë politike nuk duhet të vijnë në shprehje kur është në pyetje e ardhmja e Kosovës. Kreu i BIK-ut ka kërkuar nga institucionet e Kosovës që të ndajnë një pjesë të buxhetit shtetëror për bashkësitë fetare. Sipas Tërnavës, për BIK-un është mjaft sfiduese që t'i sigurojë çdo muaj pagat e 2 000 punëtorëve. Me rastin e Fitër Bajramit, myftiu Tërnavë ka bërë thirrje që të zgjatet dora e pajtimit dhe të ndërpriten armiqësitë



EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), Naim Tërnavë, ka ftuar spektrin politik për bashkim. Ai ka deklaruar se liderët politikë çdoherë duhet të jenë njëzëri kur është në pyetje interesi kombëtar i Kosovës. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tërnavë ka thënë se ndasitë politike nuk duhet të vijnë në shprehje kur flitet për të ardhmen e vendit. "Shfrytëzoj këtë rast që në këtë muaj të shenjtë të Ramazanit ta ftoj spektrin politik të Kosovës që kur është në pyetje interesi kombëtar i shtetit tonë të mos kenë ndasi mes vete. Kur është në pyetje çështja e ardhmërisë së Kosovës duhet të gjithë të jenë të bashkuar dhe të flasin me një zë, sepse kështu na thërret vatani dhe gjaku i derdhur i dëshmorëve. Mospajtimet politike nuk guxojnë të reflektohen kur është në pyetje ardhmëria e Kosovës. Pra, i ftoj të gjithë që të kenë njëmendësi në raport me ardhmërinë e vendit", ka thënë Tërnavë. Ai ka kërkuar nga institucionet që të

ndajnë një pjesë të buxhetit për bashkësitë fetare. Sipas Tërnavës, për BIK-un është mjaft sfiduese që t'i sigurojë çdo muaj pagat e 2 000 punëtorëve. "Edhe një herë apeloj te Qeveria e Kosovës që ta ngrehë këtë çështje në Kuvend dhe më pas Kuvendi të marrë një vendim që bashkësive fetare t'u ndahet buxheti, në mënyrë që nëpunësit e këtyre bashkësive t'i kenë pagat e sigurta dhe jo të na ndodhë siç kemi raste që të shtyhen pagat për tre muaj", është shprehur Tërnavë.

"Epoka e re": Z. Tërnavë, ju tanimë e keni marrë edhe mandatin e katërt për ta udhëhequr Bashkësinë Islame të Kosovës. Cilat janë objektivat e juaja në këtë mandat?

Tërnavë: Fillimisht dëshiroj që besimtarëve të besimit islam në Kosovë dhe në diasporë t'ua uroj këtë muaj të shenjtë, duke e lutur Zotin e madhërisëm që t'ua pranojë agjërimin dhe adhurimet e bëra në këtë muaj. Njëherësh dëshiroj t'i falënderoj të gjithë nëpunësit e

Bashkësisë Islame të Kosovës për besimin që më kanë dhënë për mandatin e katërt që të jem në krye të BIK-ut. Besimin e tyre e marrë si një përgjegjësi, sepse gjendemi në krye të një institucioni i cili ballafaqohet me sfida të ndryshme dhe i cili do një përkushtim të vazhdueshëm. Mirëpo falë angazhimit të Bashkësisë Islame dhe nëpunësve të saj ia kemi dalë.

Objektivi tona në këtë mandat janë që te njerëzit dhe te besimtarët e besimit islam të jemi të pranishëm edhe më shumë, pra të mundohemi që me punën tonë të gjithë njerëzit t'i largojmë nga dukuritë negative, t'i udhëzojmë në rrugë të mirë dhe të mbarë. Po ashtu, jemi të angazhuar që të kontribuojmë për një mirëqenie të përgjithshme në Kosovë dhe për një solidaritet në mes të njerëzve. Gjithashtu, jemi të thirrur që të kontribuojmë për paqe, harmoni, tolerancë dhe për një bashkëjetesë në mes të besimeve që është një traditë e njohur e kombit shqiptar.

Objektivi ynë tjetër është ngritja e infrastrukturës së BIK-ut, në veçanti gjatë kësaj vere ta fillojmë edhe ndërtimin e xhamisë qendrore këtu në Prishtinë. Kjo xhami po pritet nga të gjithë besimtarët. Këto ditë do të përfundojë projekti i xhamisë dhe besoj se brenda një kohe relativisht të shkurtër të fillojë ndërtimi i xhamisë së re në Prishtinë. Këto dhe shumë synime të tjera janë në agjendën time si myfti, por edhe të bashkëpunëtorëve të mi dhe nëpunësve të BIK-ut në tërë Kosovën.

"Epoka e re": Gjatë muajit të shenjtë të Ramazanit edhe kërkesat e besimtarëve janë më të mëdha. Çfarë aktivitete ka pasur BIK-u gjatë këtij muaji për t'i ndihmuar besimtarët?

Tërnavë: Është e vërtetë se kërkesat e besimtarëve janë të shumta dhe të natyrave të ndryshme. Së pari besimtarët kërkojnë prej neve që me punën tonë, ligjëratat tona dhe praninë tonë të punojmë më shumë për xhemat, që përmes

ligjëratave t'ua pastrojmë zemrat dhe mendjet e tyre. Pra, kërkohet nga ne që ata t'i ushqejmë me fjalën e të madhit Zot dhe fjalën e të dërguarit të tij.

Kërkesat janë edhe të natyrave të tjera si: prania e imamëve nëpër xhami më shumë se muajve të tjerë, mbajtja e tribunave të natyrave të ndryshme, pastaj ligjërimi i grupit të imamëve të përcaktuar nga kryesia e BIK-ut të cilët kanë dalë në terren ditëve të xhumave, por edhe netëve të Ramazanit. Pastaj, edhe shtrimi i iftareve të përbashkëta ka qenë aktiviteti ynë. Pra, në këtë mënyrë jemi munduar që xhematit tonë t'ia plotësojmë kërkesat. Po ashtu, duke e ditur se muaji i Ramazanit është muaji i solidaritetit dhe sakrificës, duhet t'ua dalim në ndihmë edhe atyre që kanë nevojë. E themi me përgjegjësi të plotë se deri tani kur po flas, që është Nata e Kadrit, kemi arritur që t'i ndihmojmë mbi 12 000 familje në Kosovë, duke u ndarë ndihma me pako ushqimore, por

n për të ardhmen e vendit



edhe ndihma të tjera. Është një numër i madh i këtyre familjeve që përmes Shoqatës 'Bereqeti' kanë gjetur përkrahjen e BIK-ut. Me këtë rast, falënderoj bizneset e vendit tonë dhe të gjithë ata që e kanë përkrahur BIK-un në këto aksione humanitare.

"Epoka e re": Vitin e kaluar keni nënshkruar një marrëveshje me Ministrinë e Drejtësisë, ku keni ofruar në dispozicion disa imamë për të ligjruar nëpër burgjet e Kosovës kundër radikalizmit. Si po shkon zbatimi i kësaj marrëveshje?

Tërnavë: Çdoherë bashkëpunimi i institucioneve të shtetit me bashkësitë fetare japin fryte. Mungesa e bashkëpunimit reflektohet dhe është reflektuar edhe te ne. Ka qenë një mungesë e bashkëpunimit në mes të këtyre institucioneve, veçanërisht pas ngjarjeve të ndryshme, pra luftërave të ndryshme në botë. Prandaj, nënshkrimi i kësaj marrëveshje ka qenë një hap shumë i mirë dhe në kohën e duhur. Kemi

arritur që në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë t'i pas-trojmë bibliotekat e burgjeve, të cilat kanë qenë në një mas të konsiderueshme me libra që nuk përkojnë me realitetin që jetojmë në Kosovë. Ato janë zëvendësuar me libra që janë botuar nga BIK-u. Pra, literatura jonë është larg çdo indoktrinimi të mundshëm. Deri më tani imamët tanë janë pritur mirë nëpër këto qendra dhe janë duke e dhënë kontributin e tyre. Në këto qendra kemi edhe disa teologe gra që po e japin kontribut të madh.

"Epoka e re": E përmendet që BIK-u çdoherë ka qenë i gatshëm për bashkëpunim me institucionet e shtetit, por sa e ka ndihmuar shteti BIK-un? Ju vazhdimisht keni adresuar kërkesa në drejtim të institucioneve?

Tërnavë: BIK-u me tërë nëpunësit e vet çdoherë ka qenë në shërbim të Kosovës. Ka qenë në shërbim të çlirimit të vendit, duke dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm në

këtë drejtim, si dhe ka kontribuar drejtpërdrejt në bërjen e shtetit të Kosovës, duke e pasur parasysh Kushtetutën që ka Kosova e cila republikën tonë e përcakton si shtet sekular. Megjithatë, e them se bashkëpunimi me institucionet e vendit është i mirë. Politika asnjëherë nuk është përzier në punët e brendshme të BIK-ut. Këtë e kemi vlerësuar gjithë dhe e vlerësojmë në vazhdimësi. BIK-u është institucion i pavarur dhe jetën e saj e organizon në bazë të Kushtetutës së vendit dhe në Kushtetutën e vet brendapërbrenda BIK-ut. Dihet se ne jemi institucion që i kemi mbi 2 000 punëtorë, që hasim edhe në vështirësi të natyrave të ndryshme. Mendoj se është një e drejtë e madhe e BIK-ut që të kërkojë nga buxheti i shtetit që të ndahet një buxhet vjetor për pagat e nëpunësve të BIK-ut dhe bashkësive të tjera fetare, sepse edhe ne jemi qytetarë të këtij shteti dhe taksapagues të këtij vendi. Prandaj, të sigurosh 2 000 paga brenda një muaji

nga ndihmat e vullnetit të popullit nuk është lehtë, sepse në këtë drejtim duhet të harxhohet një energji shumë e madhe. Kur dihet se Kosova ekonomikisht nuk qëndron mirë, kjo bëhet edhe më problematike. Edhe një herë apeloj te Qeveria e Kosovës që ta ngrëjë këtë çështje në Kuvend dhe më pas Kuvendi të marrë një vendim që bashkësive fetare t'u ndahet buxheti në mënyrë që nëpunësit e këtyre bashkësive t'i kenë pagat e sigurta dhe jo të na ndodhë siç kemi raste që të shtyhen pagat për tre deri në muaj.

"Epoka e re": Ju këtë kërkesë e keni adresuar disa herë. A keni marrë përgjigje?

Tërnavë: Përgjigja që kemi marrë është se bashkësitë fetare nuk financohen nga buxheti i shtetit. Unë çdoherë kam kërkuar që në këtë drejtim të respektohen standardet evropiane, sepse edhe ne jemi pjesë e Evropës. Për shembull, në shumë shtete të Evropës financohet feja. Në Gjermani

qytetarëve nga paga vjetore u ndalet një pjesë e të ardhurave të tyre të cilat shkojnë për kishën. Do të ishte mirë që edhe te ne këto gjëra të rregullohen në këtë mënyrë. Po ashtu, tash e 20 vjet ende nuk është rregulluar statusi juridik i bashkësive fetare. Është punuar në këtë drejtim dhe besoj se në të ardhmen e afërt edhe kjo duhet të kalojë në Kuvend në mënyrë që edhe bashkësitë fetare ta kenë statusin e tyre juridik.

"Epoka e re": Kosova po kalon nëpër disa sfida jo të lehta, derisa spektri politik nuk është shumë unik. Si i pari i myslimanëve të Kosovës, çfarë do t'ju rekomandoni liderëve politikë?

Tërnavë: Është e vërtetë se Kosova edhe 20 vjet pas luftës po kalon nëpër sfida të shumta. Pavarësisht prej këtyre sfidave, vendi ka ecur përpara në fusha të ndryshme, mirëpo sigurisht se kemi edhe ngecje të natyrave të ndryshme. Shfrytëzoj këtë rast që në këtë muaj të shenjtë të Ramazanit të ftoj spektrin politik të Kosovës qëkur është në pyetje interesi kombëtar i shtetit tonë të mos kenë ndasi mes vete. Kur është në pyetje çështja e ardhmërisë së Kosovës duhet të gjithë të jenë të bashkuar dhe të flasin me një zë, sepse kështu na thërret vatani dhe gjaku i derdhur i dëshmorëve. Mospajtimet politike nuk bën të reflektohen kur është në pyetje ardhmëria e Kosovës. Pra, i ftoj të gjithë që të kenë njëmendësi në raport me ardhmërinë e vendit.

"Epoka e re": Meqenëse jemi në prag të festës së Fitër Bajramit, cili është mesazhi juaj për besimtarët myslimanë?

Tërnavë: Mesazhi im është ai që vjen nga vetë muaji i shenjtë i Ramazanit. Kur kemi parasysh që në këtë muaj i madhi Zot zbriti Kuranin, librin udhërrëfyes për mbarë njerëzimin dhe vetë mesazhi i Ramazanit është që njerëzit në vazhdimësi të jenë në përkushtim ndaj krijuesit, të jenë në adhurim të vazhdueshëm ndaj tij dhe të jenë solidarë ndaj njëri-tjetrit. Të gjithë bashkërisht të japin kontribut që të ndërpriten gjakderdhjet anekënd botës, sepse feja islame është kundër luftërave dhe kundër gjakderdhjeve. Kështu që, duke uruar për këtë festë të Fitër Bajramit, dëshiroj që në familjet tona të ketë shëndet, mirëqenie të përgjithshme dhe ta presim ditën e Bajramit ashtu siç i ka hije, duke e uruar njëri-tjetrin dhe duke ia zgjatur dorën e pajtimit njëri-tjetrit. Të gjithë besimtarëve, urime festa e Fitër Bajramit!

Mustafa: Nuk e përjashtojmë koalicionin parazgjedhor me Vetëvendosjen



PRISHTINË, 2 QERSHOR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, vlerëson se qeveria Haradinaj e ka humbur moti legjitimitetin dhe se është duke u përballur me skandale të njëpasnjëshme dhe duhet t'i ndërpritet mandati.

Ish-kryeministri Mustafa thotë se Kosova ka nevojë të bëjë ndryshime dhe që kjo qeveri të bjerë sa më shpejt, pasi nuk mund të çojë përpara asnjë proces, siç është dialogu, njohjet, liberalizimi i vizave dhe integrimi në BE. Për këtë qëllim thotë se tashmë kanë vendosur që bashkë me Vetëvendosjen dhe PSD-në të ngritin mocion mosbesimi për qeverinë.


I pari i LDK-së thotë se janë të gatshëm për zgjedhje të reja dhe se tashmë kanë edhe platformën zgjedhore, e cila parasheh që kjo parti të shkojë e vetme në zgjedhje. Por, nuk përjashton një koalicion parazgjedhor me Vetëvendosjen,

nëse partitë në pushtet synojnë të shkojnë prapë bashkë në zgjedhje. E pranon se si e vetme nuk mund t'i arrijë synimet për ta dërguar PDK-në në opozitë, me të cilën thotë se më nuk do të bashkëqeverisin asnjëherë. "Kjo marrëveshje nuk do të thotë që ne të shkojmë vetë. Ne duhet ta shohim si është situata. Nëse të tjerët bëhen bashkë, atëherë ne e dimë paraprakisht se nuk do të arrijmë t'i mundim dy apo tri parti bashkë dhe në këtë aspekt ne do të vlerësojmë si LDK mënyrën e të shkuarit në koalicion. Me kë do të shkojmë në koalicion nuk e kemi vendosur. Nuk kemi ndonjë përkufizim të veçantë. Kemi një bindje të LDK-së dhe timen se nuk duhet të shkohet me PDK-në. Është një parti që objektivisht e ka kapur shtetin, të gjitha institucionet e shtetit, ndërsa me të tjerët do të bëjmë përpjekje të gjejmë gjuhë", ka thënë Mustafa për "EkonomiaOnline".

Policia gjen rreth një kilogram drogë në veturë, arrestohet 22-vjeçari

DEÇAN, 2 QERSHOR (ER) - Njësitë e stacionit policor në Deçan më 1 qershor rreth orës 09:50, pas një pune operativo-hetimore në fshatin Isniq, kanë identifikuar dhe arrestuar personin e dyshuar I. S., lindur më 1997. Gjatë kontrollit në veturën e tij është gjetur një sasi e narkotikëve që dyshohet të jetë e llojit 'marijuanë', e cila, pasi është peshuar nga Njësitë i Hetimit Kundër Trafikimit të Narkotikëve - Pejë, ka rezultuar të jetë 869.6 gramë. "Njësitë i Hetimit Kundër Trafikimit të

Narkotikëve -Pejë (DHTN), së bashku me njësitë e Stacionit Policor në Deçan, me urdhër të prokurorit të shtetit dhe gjyqtarit të Gjykatës Themelore në Pejë, kanë bërë kontroll-bastisje në pronën e të dyshuarit, por gjatë bastisjes nuk është gjetur asgjë e dyshimtë. Me urdhër të prokurorit të shtetit i dyshuari ndalohet për 48 orë, për t'i vazhduar hetimet e mëtejshme nga Njësitë i Hetimit Kundër Trafikimit të Narkotikëve - Pejë (DHTN)", është thënë në njoftimin e policisë.



Paraburgim për dy persona që keqpërdorën detyrën zyrtare



PRISHTINË, 2 QERSHOR (ER) - Gjykata Themelore në Prishtinë ka caktuar nga një muaj paraburgim kundër të pandehurve V. T. dhe D. K. për shkak të veprave penale 'Pjesëmarrja ose organizimi i

grupit kriminal të organizuar' me veprat penale 'Keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar' dhe 'Marrja e rryshfetit'. Sipas njoftimit, gjykata ka konstatuar se është përmbushur kri-

teri për paraburgim ngaqë ekziston rreziku që të njëjtit, po të gjenden në liri, mund të arratisen dhe në këtë mënyrë ta pengojnë rrjedhën normale të procedurës penale, të pandehurit mund të ndiko-

jnë në dëshmitarë, t'i fshehin provat e veprës penale apo të falsifikojnë ndonjë provë që të shërbejë si alibi për të pandehurit, me qëllim të shmangies nga përgjegjësia penale.

Limaj kujton tre bashkëluftëtarët në 20-vjetorin e rënies

MALISHEVË, 2 QERSHOR (ER) - Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka përkujtuar tre bashkëluftëtarët Ejup Kryeziun, Kujtim Krasniqin dhe Milaim Behën në 20-vjetorin e rënies. Limaj përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka bërë me dije

se ka vizituar vendin e rënies së tyre heroike. "Ejupi, Kujtimi, Milaimi dhe dëshmorët tjerë të kombit ishin djemtë më të mirë të këtij vendi të cilët nuk kursyen asgjë për lirinë e Kosovës. Liria të cilën e gëzojmë sot është arritur falë gjakut dhe sakrificës së shqiptarëve ndër breza. 20 vjet më parë, në

luftimet ballë për ballë me forcat pushtuese serbe, ranë në fushën e nderit, për të mos vdekur kurrë, bashkëluftëtarët e mi Ejup Kryeziu, Kujtim Krasniqi dhe Milaim Beha. Në nderim të jetës dhe veprës së tyre bëra homazhe në vendin e rënies së tyre heroike", ka shkruar Limaj.



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë pjesë në Forumin e Sigurisë "?? Be Secure" në Budvë

Thaçi: Jam i pakënaqur me qëndrimin e BE-së në raport me Kosovën

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka shprehur pakënaqësi ndaj Bashkimit Evropian (BE) që nuk e ka vlerësuar drejt progresin në Kosovë sa i përket liberalizimit të vizave. Megjithatë, ai ka thënë se rruga dhe alternativa e vetme e Kosovës është e ardhmja evropiane dhe anëtarësimi në NATO. Sipas Thaçit, durimi i Kosovës do të jetë më i madh se vonesa e BE-së

EPOKA E RE **Faton DERMAKU**

BUDVË, 2 QERSHOR - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, bashkë me homologun malazez Milo Gjukanoviq, të dielën si panelistë kanë marrë pjesë në një diskutim të hapur në Forumin e Sigurisë "?? Be Secure" në Budvë.

Presidenti Thaçi ka thënë se vendet e Ballkanit Perëndimor i kanë sfidat përafërsisht të njëjta dhe po punohet për t'i përmirësuar raportet ndërfqinjësore dhe për ta përmbyllur çdo çështje të hapur. "Këto pengesa janë të tejkalueshme nëse nuk biem në pozicionet e politikës ditore dhe populiste", ka deklaruar ai.

Pas sukseseve të jashtëzakonshme të anëtarësimin të Malit të Zi në NATO, marrëveshjes së Prespës në mes të Maqedonisë Veriore dhe Greqisë për perspektivën e sigurt të Maqedonisë në NATO, krijimit të ushtrisë së Kosovës dhe hapave që po bëhen për partneritetin për paqe, pavarësisht prej dallimeve, presidenti Thaçi ka shprehur optimizëm se rajoni është në rrugë të sigurt drejt së ardhmes euroatlantike. "Jam një prej njerëzve që më së tepërmi jam i

pakënaqur me qëndrimin e ngurtë të Bashkimit Evropian në raport me Kosovën, që nuk e ka vlerësuar drejt progresin që po ndodhë në Kosovë, në veçanti për liberalizimin e vizave. Kanë përdorur standarde të dyfishta në raport me Kosovën, që ka sjellë natyrisht një pakënaqësi, në të njëjtën kohë ne si lidhshmëri e dimë se rruga e vetme për ne, alternativë e vetme, është e ardhmja evropiane dhe anëtarësimi në NATO. Durimi ynë do të jetë edhe më i madh sesa, ndoshta, vonesa e Bashkimit Evropian", ka thënë presidenti Thaçi.

Kreu i shtetit ka theksuar se të gjithë kemi mësuar nga e kaluara, se ku ka çuar nacionalizmi dhe populizmi. "Ne jemi shumë të përcaktuar dhe po i formësojmë shoqëritë shumëmetrike në vendet tona, por jam i bindur se sa më tepër vonohet Bashkimi Evropian, aq më tepër populizëm do të ketë. Sot patriotizmi më i madh është kultivimi i këtij multietniciteti, është zhvillimi ekonomik, sjellja e investitorëve të huaj, krijimi i vendeve të punës dhe rritja e mirëqenies social", ka thënë presidenti Thaçi.

I pari i vendit ka deklaruar se tashmë mbetet sfida normalizimi i



raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, që është sfida e madhe jo vetëm për Kosovën dhe Serbinë, por për krejt rajonin.

Ndërsa i pyetur për aksionin e Policisë së Kosovës kundër krimit të organizuar në tërë vendin, presidenti Thaçi ka thënë se është bërë zhurmë e madhe për aksionin e policisë në raport me kontrabandën dhe korrupsionin ndaj individëve të caktuar, por ai nuk ka qenë i fokusuar vetëm në veriun e Kosovës, por në tërë vendin. "Ballinat e medieve të Beogradit të gjitha thoshin se ishte fushatë kundër serbëve por, jo, është goditur një rrjet i krimit të organizuar shumëmetrik, i përbërë nga serbë, shqiptarë, boshnjakë dhe komunitete të tjera jo

vetëm në veri, por në gjithë Kosovën", ka deklaruar presidenti.

Për dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë presidenti Thaçi ka thënë se realisht është në krizë, por ka shumë faktorë që kanë ndikuar për ta sjellë në këtë gjendje. "E para, raporti Kosovë - Serbi është shumë i ndjeshëm për shkak të së kaluarës së hidhur dhe, në anën tjetër, edhe për shkak të vëndit të vendit për ta marrë vendimin strategjik për një marrëveshje përfundimtare në mes të Kosovës dhe Serbisë. Është i ndjeshëm në Prishtinë, por është i ndjeshëm edhe në Serbi për shkak të mitit të rrejshëm që ka krijuar Beogradi në raport me Kosovën", është shprehur presidenti Thaçi.

Nëse Kosova dhe Serbia mund të arrijnë gjatë këtij viti një marrëveshje përfundimtare, presidenti Thaçi ka thënë se përfitimet do të jenë shumë të mëdha. "Kosova do të njihet menjëherë nga pesë vendet e Bashkimit Evropian. Do të jetë edhe pjesë e OKB-së, do të ketë edhe njohje globale dhe anëtarësim të gjithanshëm në të gjitha organizatat ndërkombëtare", ka thënë presidenti Thaçi. I pari i vendit ka theksuar se Kosova është plotësisht e orientuar drejt së ardhmes dhe po punon pa ndërprerje ta forcojë perspektivën evropiane. Forumi i Sigurisë "To Be Secure" është organizuar nga Këshilli Atlantik nën përkujdesjen e Qeverisë së Malit të Zi.

Veseli thotë se tribunali për gjenocidin serb në Kosovë është i domosdoshëm

VITI, 2 QERSHOR (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, ka bërë thirrje që të ketë unitet për themelimin e tribunalit për gjenocidin serb në Kosovë, duke potencuar se themelimi i këtij tribunalit është i domosdoshëm. "Sa për të kaluarën, ne kemi pjesën e kontributit dhe kërkohet që të mos cenohet nga askush, as për UÇK-në, as për luftën tonë të drejtë. Unë kam marrë një iniciativë për tribunalin vetëm për të drejtën e kombit tonë. Mos të lejojmë që të cenohet gjaku ynë, por edhe në të ardhmen mos të na përsëritet. Është shumë e rëndë kur i kujtojmë sakrificat. Ne jemi faqebardhë që të krijojmë perspektivë për Ballkanin dhe



për Kosovën, duke u orientuar nga e ardhmja që të kemi ekonomi të zhvilluar dhe perspektivë, për inovatorin e ndërmarrësin, të riun dhe të rejat", ka thënë Veseli të dielën në takimim që ka pasur me struktu-

rat e reja të Degës së PDK-së në Viti.

Duke folur për zgjedhjet e brendshme në PDK, Veseli ka vlerësuar procesin demokratik dhe gjithëpërfshirjen, pjesëmarrjen masive në të gjitha nën-

degët dhe degët e PDK-së, duke potencuar se ne kemi vizion, qëllim dhe përkushtimin e të gjithëve për t'i dhënë energji vendit tonë. "PDK-ja është forca më e madhe politike e cila ka transformuar shtetin që nga pavarësia e deri te konsolidimi i plotë. Në këtë rrugëtim, PDK-ja ka realizuar projektet më të mëdha në të gjitha fushat e qeverisjes. Por, po ashtu, janë bërë edhe gabime nga të cilat PDK-ja është përmirësuar dhe ka larguar e po largon nga vetja njerëz që kanë keqpërdorur PDK-në dhe shtetin. Ndërkohë nga përmirësimet po na bashkohen shumë të rinj e të reja, profesionistë të profileve shumë të vlefshme për Dekadën e Re", ka thënë Veseli.

Duke folur për Komunën e Vitisë, Veseli ka thënë se ajo ka resurse të mëdha. "Ejani ta bëjmë këtë transformim që njerëzit t'i orientojmë kah vendet e reja të punës. Duhet të kemi besim se mund të ecim përpara ashtu siç me besim e mundëm Serbinë. Me përgjegjësi e angazhim e vendosmëri do të ecim përpara. PDK-ja po rritet, njerëzit po vijnë me ne dhe ne duhet të jemi me ta. Disa po largohen dhe mirë po bëjnë që po largohen. Njerëzit e rinj i duhen vendit që nuk mendojnë vetëm për vetveten. Secili prej jush, veçanërisht rinia, duhet të bëjmë që ëndrrat e rinisë të jenë pjesë e realitetit", ka thënë Veseli.

Kur gazetaria online viktimizohet nga rrjetet sociale, cilat janë sfidat e profesionistëve?



Nga Musa SABEDINI

Sulmi ndaj një gruaje të pafajshme, me aq brutalitet fizik dhe mediatic, flet qartë për probleme serioze etike dhe teknike në fushën e gazetarisë. Këto sulme joprofesioniste nga fusha e gazetarisë online do të vazhdojnë të ndodhin edhe në të ardhmen nëse nuk imponohet një edukim medial nga vetë pronarët, redaktorët dhe gazetarët. Rrjetet sociale vazhdojnë ta infektjnë gazetarinë e shëndoshë online, e cila, ndonëse me numër të kufizuar për nga korrektësia dhe objektiviteti, vazhdon të jetë e pranishme. Gazetarët patjetër duhet t'i përmbahen maksimums së njohur "hulumto, verifiko dhe raporto", ta ruajnë etikën dhe kodet e saj, ta ruajnë atë pak kredibilitet dhe ndershmëri profesionale në gazetari.

"Kur bie telefoni në mesnatë, zjarrfikësit i duhet vetëm t'i veshë pantallonat dhe të shuaj flakët. Kurse gazetari duhet t'u tregojë një milion vuhave se kush e ndezi shkrepësen dhe pse" (Mort Rosenblum, Associated Press). E mora jorastësisht këtë citat, sepse mendoj se është shumë aktual në sulmet e fundit ndaj një gruaje rome dhe jo vetëm asaj. Fitali nxitës ishin rrjetet sociale të shumta dhe të pakontrolluara. Ishin rrjetet false ato që i dhanë publicitet negativ dhe shkatërrimtar një rasti, i cili pastaj si lajm i rremë u bartë si rrufeja te portalet kryesore. Nuk dëshiroj ta minimizoj përgjegjësinë që kanë shumica e portaleve që kanë transmetuar një lajm kaq joetik dhe kaq joprofessional, por dua ta vë në spikamë mënyrën se si portalet shërbehen nga rrjetet sociale, mënyrën se si infektohen ose viktimizohen nga këto rrjetet sociale.

Krejt filozofia e gazetarisë hulumtuese dhe profesionale qëndron tek e vërteta. Pra, si ta

themi të vërtetën, si ta bindim publikun dhe lexuesin që jemi objektivë dhe jemi etikë në atë që themi. Kjo është lufta e çdo mediumi dhe e çdo gazetari të sinqertë, të ndershëm dhe të përkushtuar.

Në këtë rast, dëmi nuk është vetëm fizik, por edhe dëm etik, madje i riparueshëm. Nëse hyni nëpër rrjete sociale, shumica e komentuesve etiketojnë dhe fyejnë portalet, pra gazetarinë online e cila dallon shumë në thelb nga rrjetet sociale.

Në "Facebook" as që pritet diçka më mirë, meqenëse niveli i atyre që komentojnë në fushën e medias është periferik, por i kushtueshëm për portalet, sepse në pyetje është kredibiliteti dhe besueshmëria e tyre.

Ku gabuan portalet?

E di që mund të ketë mospajtime edhe nga kjo kategori e medias, por ne duhet t'i pranojmë gabimet kur rrëshqasim profesionalisht. Tekefundit, gabimet mund të jenë njerëzore dhe mund të korrigjohen kur distancohesh prej tyre me kohë.

Viktima janë kryesisht portalet që nuk i verifikojnë lajmet nga rrjetet sociale, por i marrin dhe i publikojnë si të vërteta. Shpesh dëgjoj nga kolegët tekta arsyetohen se ne po e citojmë burimin. Ju lutem, raportimi për situatat e ndjeshme, raportimi për krimet, dhunën etj., kërkon shumë përgjegjësi, kërkon shumë llogaridhënie dhe verifikim. Edhe manipulimi i fotografisë ishte diçka e veçantë dhe sikur e porositur.

Të kthehemi te çështja kryesore dhe ajo që po më shqetëson shumë dhe thjesht po ndihem në siklet kur po shoh e vërejt gabime amatore.

Gjithmonë kam kërkuar dhe kam qenë ihtar i rregullimit të portaleve dhe tani fatmirësisht e kemi KMSHK, kemi kodet, kemi kriteret se çka duhet dhe çka nuk duhet të botojnë portalet. Por, është një gabim teknik i cili mund të zbatohet në momentin e regjistrimit të një portali.

Jo gjithkush mund të bëhet pronar i një portali. Kam insistuar dhe propozuar që në momentin e regjistrimit të një portali, qoftë si biznes individual, kriter kryesor të jetë fakulteti i mbaruar i gazetarisë për themeluesin e portalit. Pse e them këtë dhe pse kjo është e domosdoshme? Një student që ka kaluar nëpër filtrat akademik dhe ka ndjekur ligjëratat e nevojshme në fushën e etikës, mënyrën e raportimit nga të gjitha situatat, ai asnjëherë nuk do të bëjë gabime fillestare që do ta dëmtojnë në thelb mënyrën e raportimit.

Pra jo të gjitha portalet kanë gabuar. Viktimë ranë portalet që u nxituan pas një lajmi të pa verifikuar. Amerikanët e kanë një thënie: "Edhe kur nëna të thotë të dua, prapë verifikoje". Pra mos ngurroni, mos hezitoni të bëni përpjekje që të merrni lajmin e duhur, lajmin e saktë e të vlerësuar nga të gjitha palët, sepse kredibiliteti i gazetarit ndërtohet vështirë, ndërsa rrënohet shumë lehtë dhe shpejt.

Shpejtësia e botimit të lajmeve, është sëmundje për shumë portale dhe kjo vështirë se mund të eliminohet aq shpejt. Tek e fundit, më mirë të jesh i dyti, por i saktë, se sa i pari dhe i pa saktë.

Në Amerikë, shtylla kryesore e gazetarisë është raportimi i fakteve të verifikueshme dhe ky është çelësi kryesor që duhet të zbatohet edhe tek ne dhe që po luftoj tash e sa kohë për këtë. Thjesht, raporto në mënyrë objektive dhe të dukshme dhe bëhu bindës ndaj burimeve dhe mos i keqpërdor apo mos i keqinterpreto ato.

Deniss McQuail, profesor i Universitetit të Amsterdimit, një nga teoricienët më të njohur të komunikimit masiv modern, etikën gazetareske e ka definuar me këtotribute:

- vërtetësia dhe saktësia
- paanshmëria dhe ndershmëria
- respekti i individualitetit dhe privatësisë
- pavarësia nga interesat e caktuara
- përgjegjësia ndaj shoqërisë dhe të mirave shoqërore

- respektimi i ligjit
- morali, bontoni dhe shija e mirë.

Ka shumë rëndësi që në rastet e tilla, pra të raportimit siç ndodhi me gruan rome, mediat të mos shfaqin paragjyqime apo emocione. Janë tre minuta kohë që ju duhen për ta verifikuar një ngjarje sot në Kosovë, hiq më shumë. Jetojmë në një kohë kur teknologjia është shumë e avancuar dhe vetëm se duhet të dimë si ta përdorim mënyrën e teknikave të raportimit.

Kam përcjellë edhe raste të vdekjeve, vrasjeve apo vetëvrasjeve, ku portalet dhe gazetaret kanë bërë skandale. Në rastin e Hamdi Sopës, p.sh., kam hasur në një titull jashtëzakonisht të çuditshëm. "Hamdi Sopa është vranë dhe pikë".

Shumë është e dobishme dhe e shëndetshme që gazetari në teren të mos rrëmbëhet nga emocionet që krijon vet ngjarja, por gjatë tërë kohës të qëndrojë i paanshëm dhe i drejtë me palët. Gjithmonë është e këshillueshme që t'u japim hapësirë palëve për të cilat jemi duke bërë lajmin, që ato të thonë qëndrimet e tyre dhe në veçanti të shmangim gjuhën e urrejtjes.

Gazetaria pas "like" po dëmton gazetarinë dhe shoqërinë

Shumë nga komentuesit e rrjeteve sociale, kur po ndodhin këto skena, zakonisht fajn e adresojnë te portalet, me arsyen se gjithçka po bëhet për një "like". Nuk e përjashtoj edhe këtë mundësi, sepse shpejtësia e lajmeve në portale ka disa të mira, por edhe anë negative. Fakti që botues e redaktor mund të jetë çdokush në brendësi të një portali, krijon edhe paqartësi në raportim apo besueshmëri të lajmit në aspektin etik.

Thjesht, skandalet e kësaj fushe vijnë pikërisht nga kjo kategori që prioritet mund ta ketë garën për klikime. Kjo kategori dëshmon se synim kryesor ka ndjekjen e "like"-ve si mënyrë për të arritur audiencën dhe realizuar

anën financiare.

Dhe këtu kemi pastaj një defekt të pranishëm ku për punën e portaleve flasin njerëzit më jo kompetentë të mundshëm. Një gazetar, redaktor, ligjërues, profesor që nuk ka përjetuar punën e të bërit gazetari ditore online, ai e ka të vështirë ta kuptojë e lëre më të flas për median online. Tek ne të gjithë fatkeqësisht bëhen ekspertë, studiues të medias online.

Në mungesë të redaksive profesionale, në mungesë të redaktorëve të shkolluar e ngritur profesionalisht dhe në mungesë të gazetarëve nga terreni, po krijojmë dhe po rrezikojmë mënyrën e të bërit gazetari profesionale, në fakt po rrezikojmë vet ekzistencën e medias profesionale.

Vetërregullimi për median online ekziston, vetëm duhet ta zbatojmë në praktikë

Është Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK), i cili prej disa vitesh merret me vetërregullimin e portaleve dhe kjo ka qenë një dritare e mirë dhe një udhëzues i dobishëm për ato portale që i kanë pranuar kodet e etikës. Vetë fakti që ka ende portale që nuk dëshirojnë të jenë nën ombrellën e KMSHK, tregon qartë se ato dëshirojnë anarki në këtë profesion dhe papërgjegjësi ndaj publikut.

Ndoshta nuk është bërë më e mira, por janë trajtuar qindra ankesa e raste interesante dhe serioze nga KMSHK. Pra rregullat i kemi, kriteret janë, kodet ekzistojnë dhe na mbetet që mndëshmëri profesionale, kredibilitet më të shtuar dhe rritje e edukim medial për ta bërë më të pranueshme dhe më të dobishme punën tonë të përditshme. Duhet ta duam këtë profesion më shumë se veten, ta respektojmë jetën private e shoqërore të secilit prej nesh, por mos të dorëzohemi në asnjë mënyrë në luftimin e të këqijave, dukurive negative, devijante, krimet të organizuar, mafias politike etj.

(Autori është gazetar shumëvjeçar dhe ligjërues në UBT, në Degën e Medias dhe Komunikimit)

Industria prodhuese shënon rritje të lehtë

Industria prodhuese në Kosovë ka shënuar rritje të lehtë në gjashtë muajt e fundit. Rritjet janë shënuar në kohën kur Kosova po zbaton masën 100 për qind të tarifës doganore ndaj importeve nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, e cila, sipas disa përlloraritjeve, ka ndikuar në rritjen e prodhimtarisë vendore

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Industria prodhuese në Kosovë ka shënuar rritje të lehtë në gjashtë muajt e fundit. Administrata Tatimore e Kosovës dhe Fondi i Kursimeve Pensionale konfirmojnë se këta gjashtë muajt e fundit është shënuar rritje kur bëhet fjalë për qarkullimin e të hyrave tek aktiviteti i bizneseve dhe rritje e numrit të punësuarave që paguajnë kontributet pensionale.

Rritjet janë shënuar në kohën kur Kosova po zbaton masën 100 për qind të tarifës doganore ndaj importeve nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina, e cila, sipas disa përlloraritjeve, ka ndikuar në rritjen e prodhimtarisë vendore. Por, asnjëri nga zyrtarët e këtyre dy institucioneve shtetërore nuk e konfirmojnë se taksa ka ndikuar në këtë

rritje.

Në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) vërehet një rritje e qarkullimit në industrinë prodhuese dhe përpunuese.

Në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë" nga ATK-ja, thuhet se prej muajit nëntor të vitit 2017 deri në muajin mars të vitit 2018, vlera e qarkullimit të industrisë prodhuese ka qenë mbi 351 milionë euro, kurse në periudhën e njëjtë, nga nëntori i vitit 2018 deri në mars të vitit 2019 (periudha e taksës doganore), qarkullimi është rritur në 536 milionë euro.

Sipas një llogaritje të thjeshtë, i bie që mbi 185 milionë euro është rritur vlera e deklaruar.

Drejtori i përgjithshëm i Administratës Tatimore të Kosovës, Ilir Murtezaj, thotë se ka rritje të qarkullimit, por nuk e

ndërlidhë këtë domosdo me efektet e taksës doganore. "Nga të dhënat e fundit që kemi ka një rritje të lehtë, por nuk kemi bërë analizë të tillë se a ka rezultuar rritja nga taksa 100 për qind apo është rezultat i zhvillimit normal të biznesit. Pra, ne mund të themi se në bazë të të dhënave ka rritje, por jo të konfirmojmë se rritja është efekt i taksës 100 për qind", ka thënë Murtezaj.

Edhe në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës është rritur numri i llogarive apo kontributpaguesve në gjashtëmuajorin e fundit. Në fund të muajit prill të vitit të kaluar, numri i llogarive aktive ka qenë 282 mijë, ndërkaq në muajin e prill të këtij viti numri i llogarive aktive ka arritur në rreth 300 mijë, çka lë të nënkuptohet se ka një rritje prej 16 mijë kontributpaguesve.

Jeton Demi, zëdhënës në Trustin e Kursimeve Pensionale të Kosovës, në një bisedë për "Radion Evropa e Lirë", ka thënë se një ndër arsytet e rritjes së kontributpaguesve mund të jetë edhe zbatimi i taksës. "Kemi një bazë të zakonshme të rritjes, në ekonominë në zhvillim, kjo gjithësi ndodh. Duke qenë se

çdo vit kemi rritje të prodhimit të brendshëm bruto 3-4 për qind, normalisht se do të ketë edhe rritje të numrit të të punësuarave. Përveç kësaj ne kemi një rritje jashtë kësaj logjike, kemi rritje të dukshme, e që mund të jenë disa faktorë; një për shkak të rritjes së vetëdijesimit të kontributdhënësve, por edhe kontributpaguesve. Përveç kësaj, rritja e prodhimit të brendshëm mund të jetë edhe nga efekti i taksës, por gjithësi shton nevojat e kapacitetit prodhues vendor për të pasur më shumë punëtorë. Pra, nuk mund të ndajë në mënyrë specifike peshën e secilit faktor, por janë disa, ndër ta është edhe efekti i taksës", ka thënë Demi.

Për efektet e taksës në prodhimin vendor disa shoqata ekonomike kanë realizuar hulumtime.

Në një raport të Institutit për Studime të Avancuara GAP, publikuar javë më parë, është vënë në pah se prodhuesit vendorë nuk kanë arritur t'i shfrytëzojnë mundësitë e taksës siç është menduar.

Ndërsa hulumtimet e Aleancës Kosovare të Biznesit dhe Klubit

të Prodhuesve të Kosovës tregojnë se janë rritur kapacitetet prodhuese dhe është rritur numri i të punësuarave në industrinë prodhuese pas vendosjes së taksës për mallrat nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina.

Qeveria e Kosovës më 21 nëntor të vitit të kaluar ka vendosur taksë 100 për qind për produktet nga Serbia dhe Bosnja Hercegovina. Ditë më parë Beogradi zyrtar ka paralajmëruar se do të ndërmarre masa ekonomike ndaj Kosovës nëse shfuqizohet taksa.

Pezullimin e taksës në vazhdimësi e kanë kërkuar nga Prishtina zyrtare, edhe Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në mënyrë që t'i jepet mundësi vazhdimit të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, i cili është bllokuar që nga vendosja e taksës.

Për mbajtjen në fuqi të taksës, Qeveria e Kosovës është kritikuar edhe nga Komisioni Evropian, sipas të cilit, ky vendim po e mban atë përgjegjëse për pengimin e tregtisë së lirë, si një prej parimeve kryesore të BE-së.



Bujar Tërstena (RFE/RL)

Ministri Reçica: Duhet të ngritet paga minimale në Kosovë

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka deklaruar se paga minimale nuk ka ndikim të skemat pensionale në rast se zbatohet plotësim ndryshimi i ligjit për kategoritë e dala nga lufta. Reçica ka thënë për "KosovaPress" se në dhjetor të vitit 2017 Këshilli Ekonomik Social ka nxjerrë një rekomandim për Qeverinë e Kosovës që paga minimale nga 130-170 sa është e

shkallëzuar të shkojë në 250. Sipas tij, para se të merrej ky vendim në këshill, por edhe tash para disa dite janë konsultuar me ekspertë ligjorë për ta interpretuar çështjen e ndikimit të ndryshimit të pagës minimale te skemat pensionale. "Ka pasur zëra pse prej 170 në 250 dhe përgjigja ime ka qenë: se po të shikohet koha prej kur është lëvizur së fundi herë paga minimale e deri në propozimin që ne kemi marrë në vitin 2017, është

një kohë bukur e gjatë, janë vite në pyetje. Përkundër krejt asaj që është bërë në drejtim të krijimit të kushteve më të mira për të bërë biznes, natyrisht nuk ka pasur një lëvizje sa i përket lëvizjes që sadopak të ndikojë te fuqia punëtorë dhe në këtë drejtim unë vazhdoj të mbetem në anën e punëtorëve dhe dua ta bëj zotimin tim publik që do të angazhohem fuqishëm që paga minimale në vend të lëvizet", ka thënë Reçica.





Kompania e Sigurimeve - Insurance Company

KOSOVA_{ERE}

*Urime Fitër
Bajrami!*

Dënimi i krimeve të komunizmit, sfidë për Kuvendin e Kosovës

Me luftën e lavdishme të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me dëbimin e forcave okupatore, terroriste serbe, krahas lirisë kombëtare, në Kosovë u krijuan kushte edhe për vendosjen e pluralizmit të vërtetë politik dhe demokratik. Por, mjerisht, edhe sot, simbolet e totalitarizmit komunist jugosllav që ende rëndojnë mbi kokat e qytetarëve, qëndrojnë në këmbë përpara institucionit ligjvënës. Këto simbole, që ta kujtojnë tmerrin dhe mizorinë e së kaluarës, nuk do të shkulen që aty derisa në Kuvendin e Kosovës, në qeverinë e saj, në shërbimin civil, në polici, në gjyqësi, në pushtetin lokal etj., qëndrojnë "kuadro" që, duke i shërbyer në të kaluarën me përkushtim e devotshmëri regjimit komunist-titist, ia kanë zgjatur vuajtjet popullit shqiptar dhe jetën atij regjimi më gjakatar që ka njohur historia jo vetëm e Kosovës



Nga: Ismet HAJRULLAHU

Dënimi i krimeve të komunizmit jugosllav është tejet i domosdoshëm jo vetëm për t'u distancuar dhe për ta dënuar sistemin e kaluar totalitar por është, gjithashtu, obligim dhe respekt për të gjithë të rënë, të vrarë prapa shpine, ku vetëm në zonat e ndryshme të Prishtinës si në Tokbahqe, Velani, Parku i Gërmisë janë të mbushura përplot me varre masive. Do të ishte një lehtësim shpirtëror edhe për ish të burgosurit politikë që u dërgjën burgjeve të diktaturës komuniste jugosllave, të internuarve e të gjithë të keqtrajtuarve nga organet e UDB-së dhe KOS-it, si dhe të spastrimit etnik, ku në marrëveshje në mes të Jugosllavisë titiste me Turqinë

(1951-1956), u shpërngulën e u dëbuan qindra mijëra shqiptarë drejt Anadollit. Në të gjitha vendet e lindjes ku sundonte komunizmi ishte i instaluar aparati i dhunës që ndëshkoi, persekutoi, burgosi me mijëra qytetarë, por komunizmi jugosllav i maskuar deri në përsosmëri mbas teorisë së "famshme" të vetadministrimit socialist, ushtroi dhunë të egër e terror në shkallë gjenocidi ndaj popujve joserbë, e veçanërisht ndaj popullit shqiptar në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare nën pushtimin jugosllav. Me luftën e lavdishme Çlirimtare të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, me dëbimin e forcave okupatore, terroriste serbe, krahas lirisë kombëtare, në Kosovë u krijuan kushte edhe për vendosjen e pluralizmit të vërtetë politik e demokratik. Por, mjerisht edhe sot, simbolet e totalitarizmit komunist jugosllav që ende rëndojnë mbi kokat e qytetarëve, qëndrojnë në këmbë mu përpara institucionit ligjvënës. Këto simbole që ta kujtojnë tmerrin dhe mizorinë e së kaluarës nuk do të shkulen që aty derisa në

Kuvendin e Kosovës, në qeverinë e saj, në shërbimin civil, në polici, në gjyqësi, në pushtetin lokal etj., qëndrojnë "kuadro" që, duke i shërbyer në të kaluarën me përkushtim e devotshmëri regjimit komunist-titist, ia kanë zgjatur vuajtjet popullit shqiptar dhe jetën atij regjimi më gjakatar që ka njohur historia, jo vetëm Kosovës. Këta ish-komunistë, që i shohim në krye të partive politike, të ulur në karriget e tempullit të demokracisë, e bashkë me ta edhe pinjollë të regjimit titist-rankovcist, baballarët e të cilëve menjëherë pas instalimit të regjimit diktatorial, vranë Haki Tahën, vranë pas shpine Xheladin Hanën, Rifat Berishën, Gjon Sereqin si dhe shumë antifashistë e antikomunistë të tjerë, mjerisht edhe sot vazhdojnë të luajnë rol me rëndësi në jetën politike - ekonomike - mediale të Kosovës. Sot edhe pas shtatë vjetëve, që kur u dëbuan forcat pushtuese nga territori i Kosovës, është krejtësisht e pakuptimtë se si në Kuvendin e Kosovës asnjëherë nuk është marrë iniciativa për ta dënuar terrorin masiv, që komu-

nizmi jugosllav për pesëdhjetë vjet e ka ushtruar mbi popullin shqiptar. Mosdënimi publik i krimeve të komunizmit jugosllav nga ana e Kuvendit të Kosovës është një shenjë e keqe, një ogur i zi për të ardhmen e Kosovës. Derisa në tërë botën demokratike, si dhe në vendet e ish-blokut të lindjes, ku është vendosur demokracia, janë dënuar krimet e diktaturave të komunizmit, tek ne ende i bëhet bisht kësaj çështjeje. Nomenklatura e sotme, pavarësisht që, para faktorit të brendshëm dhe faktorit ndërkombëtar, bën be e rrëfe se është demokratike e mirëfilltë, duke i ikur dënimit të së kaluarës së errët komuniste, e rendit Kosovën përkrah shteteve më diktatoriale, siç është sot Bjellorusia. Mosdënimi i skllavërisë moderne mund të kuptohet për dy arsye: e para, ngase institucionet e Kosovës janë të mbushura përplot me ish-bashkëpunëtorë të shërbimit famëkeq të UDB-së, diktaturës komuniste-jugosllave dhe, e dyta, ngaqë oportuniteti i disa liderëve partiakë, të cilët jo vetëm që ia hapën dyert e partive për personat personifikues të komunizmit titistë në emër të masivizimit të partisë, por edhe iu krijuan hapësira të mëdha që të futen dhe të drejtojnë institucione dhe organizma me rëndësi shoqërore dhe kombëtare. Ky nënshtrim ndaj përfaqësuesve të skllavërisë komuniste jo vetëm se nuk i shërben ndërtimit të një sistemi demokratik në Kosovë, por është pengesë për t'u shkëputur nga e kaluara e errët dhe për t'i dënuar krimet e komunizmit jugosllav të cilat për qyte-

tarët e Kosovës janë ende plagë të freskëta. Partitë politike, organizatat joqeveritare, të cilat punojnë për të drejtat e njeriut, në veçanti Shoqata e të Burgosurve Politikë, si dhe qytetarët e Kosovës, nuk duhet të qëndrojnë indiferente ndaj kësaj çështjeje, por duhet t'i bëjnë presion Kuvendit për t'i dënuar krimet e barbarisë komuniste, i cili është zbatuar me egërsinë më të madhe në Kosovë gjatë spastrimit të "reaksionit ballist" para dhe pas 1945-s, gjatë aksionit famëkeq të armëve në vitin 1956, gjatë dëbimeve masive për në Turqi dhe nëpër vendet e ndryshme të botës, si dhe gjatë terrorit dhe masave barbare të vitit 1968, 1981 e më vonë. Prandaj nisur nga këto fakte është, para së gjithash, obligim njerëzor e kombëtar që Kuvendi i Kosovës në frymën e dy rezolutave të Bashkimit Evropian për dënimin e krimeve të komunizmit dhe hapjeve të dosjeve t'i zbatojë rezolutat e saj, duke nxjerrë një rezolutë për dënimin e krimeve pesëdhjetëvjeçare të komunizmit jugosllav në Kosovë. Me këtë rast, Kuvendi po ashtu duhet të nxjerrë një ligj për kompensimin material të të burgosurve politikë, për pjesëtarët e familjeve të dëshmorëve të të gjitha periudhave, si dhe për ata që u dëbuan dhunshëm nga vendi, duke lënë mbrapa varret e të parëve dhe pronat e tyre. Kuvendi i Kosovës nuk mund të mbetet edhe më tej mriz ku "mri-zojnë" kriminelët e titizmit!

(Ky artikull është publikuar në disa nga mediat e shkruara në vitin 2006)

Nismës në Gjakovë i bashkohen dhjetëra anëtarë të rinj

GJAKOVË, 2 QERSHOR (ER) - Nisma Socialdemokrate, Dega në Gjakovë, ka shënuar pesëvjetorin e themelimit. Në shënim të pesëvjetorit, Nismës në Gjakovë i janë bashkuar mbi 50 qytetarë të rinj të moshave e profesioneve të ndryshme. Kryetari i Nismës, Fatmir Limaj, u ka uruar mirëseardhje anëtarëve të rinj si dhe i ka uruar strukturat për pesëvjetorin e themelimit të Nismës në Gjakovë. Ai u ka shprehur mirënjohje të gjithë atyre aktivistëve dhe votuesve të cilët u rreshtuan dhe besuan në këtë filozofi politike në këta pesë vjet. "E di që s'ka qenë e lehtë dhe jeni ballafaquar me sfida të shumta, por ne jemi këtu tash pas pesë vjetëve më të fuqishëm se kurrë, duke ju falënderuar



juve. Angazhimi, përkushtimi juaj, zgjerimi i këtyre frymë politike anekënd Komunes së Gjakovës", ka thënë Limaj. Ai ka thënë se Nisma është një parti politike e cila në vete përmban pozitivitet, unitet,

vendosmëri dhe një subjekt politik që nuk vrapon pas numrit, por pas ideve. Më tutje zëvendëskryeministri i Kosovës ka thënë se partia të cilën ai e drejton është forca vendimtare në skenën politike të Kosovës

duke numëruar një serë suksesesh dhe iniciativash të iniciuara nga Nisma në Kuvend dhe qeveri. "Filozofia jonë politike është shtetformuese. Përfaqësuesit tanë në qeveri dhe Kuvend veprojnë dhe punojnë me logjikë shtetformuese. Koha ka dëshmuar se sa i nevojshëm ka qenë themelimi i Nismës. Nisma inicioi nxjerrjen e rezolutës në Kuvendin e Kosovës, e cila dënon gjenocidin serb në Kosovë", ka shtuar Limaj. Limaj ka numëruar një serë suksesesh të tri ministrive të Nismës në Qeverinë e Kosovës, duke përmendur reformat në arsim, ligjin për arsimitarët e viteve të '90-ta, përkushtimin ndaj prodhuesve vendorë, reformat pensionale dhe Ligjin për

lehoninë. Sa i përket dialogut me Serbinë, Limaj ka thënë se përplasjet në mes të liderëve po e dëmtojnë Kosovën duke shtuar se Nisma është ihtarë që për këtë temë të ketë bashkim. Limaj ka thënë se Nisma po fuqizohet anekënd Kosovës. Kryetari i Degës së Nismës në Gjakovë, Fazli Hoxha, ka thënë se sot janë mbledhur për ta kremtuar pesëvjetorin e Nismës në Gjakovë si dhe për t'i prezantuar aderimet e reja. Ai ka thënë se rrugëtimi pesëvjeçar i Nismës është përcjellë me sfida të shumta. Hoxha ka thënë se Nisma është parti e cila ka shtrirje në gjithë regionin e Gjakovës dhe ka strukturë të organizuar. Ai e ka siguruar Limajn se në Gjakovë besimi për Nismën po rritet çdo ditë e më shumë.

Me fat Fitër Bajrami!

IPKO ju uron të gjithë
besimtarëve muslimanë
festën e shenjtë të
Fitër Bajramit.



Me fat Fiter Bajrami!

KEDS **KES|CO**

vipa
SHIJE E PAREZISTUESHME

PESTOVA
NËSE FLITET PËR PATATE

Urime festën e
FITER BAJRAMIT

<p>2011 2012</p>	<p>2011/2012 - SUPERBRENDET, ZGJEDHJA E KOSOVËS 2011/2012 SUPERBRANDS KOSOVO'S CHOICE</p>	<p>2013</p>	<p>ÇMIMI PËR ARRITJE NË KUALITET ESOR'S, LONDRË 2013 ESOR'S QUALITY ACHIEVEMENTS AWARD LONDON 2013</p>	<p>2014 2015</p>	<p>2014/2015 - SUPERBRENDET, ZGJEDHJA E KOSOVËS 2014/2015 SUPERBRANDS KOSOVO'S CHOICE</p>
<p>2012</p>	<p>HARKU I EVROPËS PËR CILËSI DHE TEKNOLOGJI NË KATEGORINË E ARTË PËR VITIN 2012 ARCH OF EUROPE FOR QUALITY AND TECHNOLOGY IN GOLD CATEGORY 2012</p>	<p>2014</p>	<p>ÇMIMI KOMPANIA INSPIRUESE DHE LIDERI INOVATIV NË BIZNESIN BOTËRORE NGA KONFEDERATA BOTËRORE E BIZNESEVE "THE BIZZY 2014" HOUSTON TEXAS, USA VENICE ITALY - 2014 INSPIRATIONAL COMPANY & INNOVATIVE WORLD BUSINESS LEADER AWARD BY WORLD CONFEDERATION OF BUSINESSES "THE BIZZY 2014" Houston Texas, USA - Given in Venice Italy - 2014</p>	<p>2015</p>	<p>KRUIJESIT E SHEKULLIT 2015, ÇMIMI SPECIAL PËR ZHVILLIMIN E IDEVE, INOVACIONIT DHE INVESTIMIT NË NËRMARRËSI NË EVROPËN JUGLINDORE, DUBROVNIK - KROACI 2015 THE CENTURY AWARD 2015, SPECIAL PRIZE FOR THE DEVELOPMENT OF IDEAS, INNOVATION AND ENTREPRENEURIAL INVESTMENT IN SOUTHEAST EUROPE, DUBROVNIK - CROATIA 2015</p>

www.vipa-ks.com

Shtyhet manifestimi "Java Remzi Ademaj - Shtigjeve të Lirisë"

PRIZREN, 2 QERSHOR (ER) - Komuna e Prizrenit ka bërë me dije se është shtyrë manifestimi tradicional "Java Remzi Ademaj - Shtigjeve të Lirisë", i cili ishte paraparë të organizohet në javën e parë të muajit qershor, përkatësisht nga 3 deri më 9 qershor. Kjo komunë

ka theksuar se për mbajtjen e këtij manifestimi opinioni publik do të njoftohet me kohë. "Shtyrja e organizimit të manifestimit është bërë si pasojë e afateve ligjore për ankesa që obligohet t'i respektojë komuna pas përfundimit të procesit të prokurimit. Afati

i ankesave, edhe pse ishte paraparë më herët, shtyrja ka ardhur si rrjedhojë e vonesave nga procedurat tenderuese. Pasi të përfundojë i gjithë ky proces do të caktohen datat e reja për organizimin e këtij manifestimi", ka njoftuar Komuna e Prizrenit.



Komuna e Skenderajt dhe 'Jetimat e Ballkanit' do t'i ndërtojnë edhe pesë shtëpi për skamnorët



SKENDERAJ, 2 QERSHOR (ER) - Komuna e Skenderajt dhe shoqatat "Jetimat e Ballkanit" do t'i ndërtojnë edhe pesë shtëpi për familjet skamnore në këtë komunë. Kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, ka bërë me dije se, përveç këtyre pesë shtëpive, janë edhe 20 të tjera që do të ndërtohen në bazë të marrëveshjes që kanë me shoqatën "Jetimat e Ballkanit", e cila drejtohet nga humanisti Halil Kastrati. "Dita nis me vizita te familjet që, megjithëse shumë miqësore, jetojnë në kushte

shumë të vështira të banimit dhe është tepër e rëndë për t'u ballafaquar me atë çfarë pamë e gjetëm. Megjithatë, dërguam lajme të mira te Selman Azemi nga Açareva, Hatiqe Hoti nga Turigeci, Halim Smakaj nga Klodernica, Skender Kajtazi nga Vitaku dhe i riu Shkëlzen Xheloshi nga Qubrel, që për rastësi me lajmin e mirë, datëlindja e tij e 11 po shënohet me lajmin për fillimin e ndërtimit të shtëpisë edhe për familjen e tij. Bashkërisht me humanistin Halil Kastrati nga shoqata 'Jetimat e

Ballkanit' ishim për vizitë te secila këto pesë familje, për t'i njoftuar për një jetë të re që do të fillojë shumë shpejt". "Për dijeninë e të gjithëve, këto familje absolutisht meritorë për shtëpi të reja janë përzgjedhur nga komisioni i komunës, ndërkaq financimi i projektit do të bëhet nga buxheti i komunës dhe 'Jetimat e Ballkanit'", ka shkruar Jashari në llogarinë e vet në "Facebook". Me këtë rast, Jashari ka falënderuar humanistin Halil Kastrati dhe të gjithë donatorët.

Së shpejti do të fillojë restaurimi i kullës së patriotit Ramë Bllaca

SUHAREKË, 2 QERSHOR (ER) - Së shpejti do të fillojë restaurimi i kullës së patriotit, atdhetarit dhe personalitetit të shquar Ramë Bllaca. Lajmin e ka bërë me dije ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi. Ai ka treguar se në fshatin Bllacë të Komunës të Suharekës ende është në këmbë shtëpia e personalitetit të njohur shqiptar, Ramë Ballaca. "Rama Bllaca ishte patriot, intelektual i mirëfilltë, politikan i spikatur si dhe trim i vërtetë i kohës, në kuadër të rrethanave politiko-shoqërore, ekonomike e

sociale në të cilën ai jetoi. Ramë Bllaca si deputet në parlamentin e qeverisë së asaj kohe e kuptoi në thellësi politikën gjenocidiale ndaj popullit shqiptar të Kosovës, qëllimet dhe pasojat e shpërnguljes së shqiptarëve nga trojet autoktone. Me qëllim të moslejimit të lëshimit të vatrave shekullore, të shpërnguljes të shqiptarëve dhe pronat e tyre t'i merrte etnikumi sllav, serb në veçanti, vuri themelet, filloi ndërtimin e kullës së tij në fshatin Bllacë, në vendlindjen e tij ku kishte lindur në vitin 1879. Themelet e kësaj

shtëpie 'kullë' nga guri i vendosi në vitin 1936", ka thënë Gashi. Ai ka shtuar se patrioti Ram Bllaca me veprimtarinë e paepur ndaj çështjes kombëtare, pos të tjerash, ndikoi edhe në vetëdijesimin e shqiptarëve që të ngelin në trojet e të parëve të tyre, në Kosovë. "Pra, lirisht mund të thuhet se Ramë Bllaca ishte një figurë, personalitet eminent i kohës dhe rrethanave shoqërore-politike të një periudhe të caktuar historike, gjysmës së parë të shek. XX", ka thënë ministri Gashi.



Shkolla 'Ibrahim Mazreku' në Malishevë shënon dy përvjetorë

MALISHEVË, 2 QERSHOR (ER) - Shkolla Fillore e Mesme e Ulët (ShFMU) "Ibrahim Mazreku" në Malishevë ka shënuar dy përvjetorë, 20-vjetorin e rënies së dëshmorit të kombit Ibrahim Mazreku dhe ditën e shkollës. Në shënimin e këtyre dy ngjarjeve kanë qenë të pranishëm përfaqësues të institucioneve lokale dhe qendrore të Republikës së Kosovës. Për historikun e shkollës "Ibrahim Mazreku" dhe për dësh-



morin që mban emrin kjo shkollë ka folur drejtori i kësaj shkolle, Januz Mazreku. Ai ka paraqitur edhe të arriturat e kësaj shkolle në procesin e rregullt edukativo-mësimor si dhe në garat dhe aktivitetet e

ndryshme në nivel komune, republike dhe jashtë vendit.

Ndërsa kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka thënë se sa herë binin në beteja dëshmorët si Ibrahim Mazreku, UÇK-ja fuqizohet edhe më shumë. "Sot për familjen, bashkëlloftëtarët e Ibrahimit, kolektivin e shkollës, nxënësit dhe qytetarët malishevas, është një ditë e veçantë, në 20-vjetorin e rënies së dëshmorit Ibrahim

Mazreku, sepse sa herë binin dëshmorët në fushëbeteja për çlirimin e Kosovës, Ushtria Çlirimtare e Kosovës fuqizohet dhe merrte aksione kundër ushtrisë serbe dhe paramilitarëve serbë, me objektivin që gjakun e dëshmorëve dhe amanetin e tyre ta bëjnë realitet sa më parë, pra çlirimin e Kosovës", ka thënë Begaj. Ai ka kërkuar nga mësimdhënësit të punojnë edhe më shumë, pasi kushtet tashmë i

kanë të mira. Po ashtu, Begaj ka kërkuar nga nxënësit të lexojnë për veprimtarinë e dëshmorëve që ua sollën lirinë.

Në fund të shënimit të kësaj ngjarje, kryetari i Shoqatës së Dëshmorëve të Luftës së UÇK-së, Dega në Malishevë, Metush Kryeziu, ka bërë me dije se Ibrahim Mazreku është shpallur hero i Kosovës nga presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi.

Hapet kopshti i fëmijëve "Dielli" në Ferizaj

FERIZAJ, 2 QERSHOR (ER) - Në Komunën e Ferizajt është hapur kopshti i ri i fëmijëve "Dielli". Ky kopsht ka një sipërfaqe prej 700 metrash katrorë dhe është realizuar nga çifti bashkëshortor Lendita dhe Jeton Hasani.

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Ferizaj, Afrim Llabjani, i shoqëruar nga pronarët e kopshtit "Dielli", kanë parë çdo cep të kësaj hapësire dhe është shprehur i impresionuar me organizimin, hapësirat e përshatshme për lojërë, ushqim dhe

fjetje për fëmijët që do ta shfrytëzojnë këtë kopsht. Ai ka thënë se një investim i tillë paraqet një standard të ri në institucionet e arsimit parafillor dhe bazë e sigurt për avancimin e komponentit të edukimit të të vegjëlve në nivelin lokal.

Kopshti "Dielli" në ceremoninë hapëse kishte përgatitur për fëmijët një program në të cilin ata janë përfshirë në lojërat e organizuara, me personazhet e filmave të animuar dhe muzikën që ka argëtuar të pranishmit. Kopshti ka



hapësirë për pranimin e 200 fëmijëve.



KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI SH.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
REGIONALNA KOMPANIJA ZA VODOSNABDEVANJE D. D.

PRISHTINA



DUAJE JETËN, KURSEJE UJIN

Kompania Rajonale e Ujësjetjesit “Prishtina”, sh.a.

Të gjithë besimtarëve islam ua uron festën e Fitër Bajramit!



E rrallë

Gjaku i balenave dhe delfinëve skuq detin

Fshatarët në një ishull të Atlantikut e bënë detin e kuq duke vrrarë balenat dhe delfinët. Më shumë se 100 balena dhe 40 delfinë u masakruan nga banorët e ishujve Faroe. Peshkatarët i kapën me metoda të veçanta peshkimi dhe i nxorën në breg, ndërkohë që "lanë" detin me gjakun e tyre.



FOTO E DITES



Një shqiponjë shihet duke kapur peshq të vegjël në Liqenin Van në Turqi. /Fotografia Anadolu Agency/

E jashtëzakonshme

Pa kokë dhe këmbë, deti nxjerr në breg breshkën e ngordhur 50 kilogramësh

Një breshkë deti e llojit "Dermochelys coriacea" është gjetur këtë javë në plazhin e vjetër në Vlorë. Breshka rreth 50 kilogramë ka dalë në breg të detit e ngordhur si rrjedhojë e kushteve atmosferike të rënuara si dhe erës



së fortë që fryn në drejtimin jugor. Breshka është gjendur e ngordhur, pa kokë si dhe pa këmbë. Kanë qenë pikërisht rrymat e forta të detit të cilat e kanë nxjerrë këtë breshkë në det.

BARSOLETA E DITËS



Në autobus, ngjitur njëri-tjetrit, ishin ulur dy veta. Njërit i vinte erë e keqe e gojës. Tjetri, për mos ta ofenduar, i thotë:

- Më falni, keni ndonjë dhëmb të prishur?
- I kam katër, por u kam vënë urë.
- Më bëhet qejfi, por shiko mos të ka rënë ndonjëri poshtë urës!




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjate vikendit ne ora 14:00

"DUMBO" 3D

Fantazi/Familjar; 1 ore 52 min

Rolet: Colin Farrell, Michael Keaton, Danny DeVito, Eva Green, Alan Arkin, etj.
Regjia: Tim Burton



Ne ora 16:00 dhe 19:00

"AVENGERS; Endgame"

Aksion/Aventurë/Fantazi; 3 ore 02 min

Rolet: Robert Downey Jr., Chris Evans, Mark Ruffalo, Chris Hemsworth, Scarlett Johansson, Don Cheadle, Bradley Cooper, Gwyneth Paltrow, Jeremy Renner, Josh Brolin, etj.
Regjia: Anthony Russo, Joe Russo



Në ora 20:00

"EXTREMELY WICKED, SHOCKINGLY EVIL, AND VILE"

Krim/Mister; 1 ore 48 min

Rolet: Zac Efron, Lily Collins, Kaya Scodelario, Jeffrey Donovan, Angela Sarafyan, Dylan Baker, John Malkovich, etj.
Regjia: Joe Berlinger



16.05.2019

"THE HUSTLE"

Komedi

Rolet: Anne Hathaway, Rebel Wilson, Alex Sharp, Dean Norris, etj.

Regjia: Chris Addison



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI
Shumë herë me atë që thoni dhe

bëni i çoni njerëzit të mendojnë ndryshe për ju. Kjo gjë ju intrigon dhe e bëni herë pas here.



DEMI
Vini në punë intuitën tuaj dhe

zgjidhni mënyrën dhe rrugën më të thjeshtë për të dalë në përfundim të një situatë që ka ngecur prej kohësh.



BINJAKËT
Duhet të jeni pak më të ashpër me

persona të caktuar sepse ju kanë vënë përballë problemesh që do t'ju rëndojnë shumë sot.



GAFORRJA
Sot duhet t'i tregoni partnerit që do t'i

gjendeni gjithmonë pranë, edhe në ato çaste që duket sikur jeni larguar.



LUANI
Një marrëdhënie e caktuar mund të

shkojë shumë më mirë nga sa e mendoni, nëse ju u lini hapësirë personave të tjerë t'ju gjenden pranë.



VIRGJËRËSHA
Sot vini në plan të parë zemrën

tuaj dhe veproni siç ju thotë ajo. Mos merrni për bazë paragjykimet e të tjerëve.



PESHORJA
Do të kujtoheni në çast të fundit për

një porosi që ju kanë lënë. Harresa juaj do të bëjë që një miqësi e vjetër të lëkundet.



AKREPI
Nëse ende nuk e keni kuptuar se çfarë duhet

të bëni, mbase është mirë të kërkonti ndihmë të personat që keni pranë.



SHIGJETARI
Sot jeni të bindur që po veproni mirë lidhur

me një çështje të caktuar. Koha do të tregojë nëse keni pasur vërtet të drejtë.



BRICJAPI
Është mirë që të filloni ta merrni

më seriozisht anën emocionale tuajën. Kjo ju ndikon në gjithçka që do të bëni më vonë.



UJORI
Dikush po përpiqet t'ju hapë

sytë dhe t'ju tregojë atë që duhet të bëni. Mundohuni ta ruani intimitetin brenda dyerve të shtëpisë.



PESHQIT
Sot do të gjendeni përballë një

problemi që ka të bëjë me punën tuaj. Nuk duhet ta lini pas dore.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

JUVENTUS - UDINESE

1-1

BREMEN - SCHAKE

2

BILBAO - ESPANYOL

1

Batatina: Zhdrella ka rinovuar, Namani nuk është larguar

Trajneri Tahir Batatina ka konfirmuar për "Epokën e re" se katër herë lojtari më i mirë në Kosovë, Mentor Zhdrella, ka rinovuar kontratën me Llapin, kurse Hamdi Namani ende nuk është larguar nga klubi. "Mentori e ka vazhduar kontratën me Llapin. Arsyeja e emërimit kapiten është për shkak të përvojës së madhe që ka ky lojtar", ka thënë Batatina

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Skuadra e Llapit ishte një nga skuadrat pretendente për titull të kampionit në IPKO Superligë, por në fund kampionatin e mbylli në pozitën e tretë. Kjo skuadër edhe përkundër përfundimit të kampionatit nuk po rrinë duarkryq, pasi të premtën ka njoftuar se e ka rinovuar kontratën me disa futbollistë të rëndësishëm, përfshirë edhe mesfushorin Mentor Zhdrella, i cili më pas e mohoi një

gjë të tillë.

Redaksia e sportit e gazetës "Epoka e re" në lidhje me këtë çështje e kontaktoi trajnerin Tahir Batatina, i cili konfirmoi se marrëveshja me katër herë lojtarin më të mirë në Kosovë është një çështje tashmë e përfunduar. "Mentori e ka vazhduar kontratën me Llapin. Arsyeja e emërimit kapiten është për shkak të përvojës së madhe që ka ky lojtar", ka thënë Batatina. Në "mjegull" vazhdon të jetë e ardhmja e mesfushorit Hamdi Namani, i cili deri në kampionatin

e fundit ishte kapiten i Llapit.

Trajneri Batatina e ka mohuar faktin se Zhdrella është emëruar kapiten, pasi Namani do të largohet nga Llapi. "Jo, nuk do të thotë se Namani do të largohet, pasi në e kemi emëruar Zhdrellën kapiten të ri. Krejt çka është folur për Namanin janë vetëm llafe të kafeve dhe shkrime të portaleve për faktin se ende asgjë zyrtare nuk ka", ka deklaruar Batatina. Llapi ka arritur të rinovojë me Mentor Zhdrellën, Behar Maliqin, Benjamin Eminin dhe Bujar Idrizin, kurse transferimi i



parë në këtë skuadër është sulmuesi Emran Ramadani. Ky i fundit është 27-vjeçar dhe ka luajtur për skuadrën e Renovës në Maqedoni. Ndërsa skuadra nga Podujeva ka njoftuar se kryesia e

klubit ka marrë të gjitha masat e nevojshme për renovimin e mëturjes së stadiumit dhe përgatitjes së fushës me intensitet të lartë për edicionin e ri të Superligës.

Vëllaznimi kërkon hetim për 'krimin' sportiv

Skuadra e Vëllaznimit nuk po arrin të qetësohet pas humbjes në ndeshjen ndaj barazhit pasi drejtuesit e klubit po pretendojnë se fajtorë për moskthimin e kësaj skuadre në Superligë është treshja e gjyqtarëve: Mervan Bejtullahu, Edmond Zeqiri dhe Fatmir Sekiraqa. Skuadra kuqezi po kërkon hetim për këtë "krim" sportiv

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 2 QERSHOR - KF Vëllaznimi pësoi humbje nga Trepça '89 (4-2) në ndeshjen e barazhit për Superligë, por klubi gjakovar është i bindur se moskthimi i tyre në elitë ndodhi pas një skenari mirë të përgatitur. Menjëherë pas përfundimit të ndeshjes që u zhvillua të shtunën, kryetari i KF Vëllaznimi, Agim Cana, hyri në zhveshtore dhe në praninë e medieve akuzoi gjyqtarët për humbjen e skuadrës që ai e drejton.

Cana pati edhe shumë akuza të tjera, por kërkoi nga futbollistët ta ngrehin kokën lart për mundin e dhënë në fushën e gjelbër. Kjo histori e akuzave ndaj gjyqtarëve nuk përfundoi me kaq, pasi Vëllaznimi të dielën lëshoi edhe një reagim

për medie, ku vlerësoi se treshja e gjyqtarëve kanë bërë mëkat ndaj skuadrës kuqezi dhe krim ndaj futbollit të Kosovës. "Rishikimi i regjistrimit të ndeshjes vetëm sa na përforcoi bindjen tonë se e tërë treshja e gjyqtarëve - Mervan Bejtullahu, Edmond Zeqiri e Fatmir Sekiraqa në këtë ndeshje kanë bërë një mëkat të madh ndaj Vëllaznimit, kanë bërë një krim ndaj klubit tonë, duke i vënë mbi supë një turp të madh futbollit kosovar", thuhet në reagimin e KF Vëllaznimit.

Skuadra e Vëllaznimit e mbylli pjesën e parë në epësi prej një goli, por në reagim thuhet se gjyqtari Bejtullahu ka sharë futbollistët kuqezi derisa në vazhdimësi ka dhënë edhe faulle të paqenë për skuadrën e Trepçës '89. "Protagonisti kryesor i këtij krimi, Bejtullahu, përpjeq t'i kamuflojë



vendimet e veta skandaloze me sjellje arrogante ndaj futbollistëve tanë, të cilëve vazhdimisht u bërtiste, i shante, i ofendonte dhe u kërcënohej. Mjafton të analizohet periudha prej 8-9 minutave para golit të dytë të barazimit të Trepçës '89, kur për këta minuta akordoi shtatë faulle në afërsi të zonës tonë të rrezikimit, shumica prej të cilëve nuk ekzistonin fare, vetëm që sa më shumë të rrezikohet porta jonë dhe kjo rezultoi me golin e dytë të Trepçës '89", thuhet në reagimin e Vëllaznimit. "Nuk e dimë se a qëndrojnë pas këtij krimi të pashembullt struktura të caktuara të FFK-së, mirëpo nëse organet përkatëse të FFK-së hes-

htin pas këtij veprimi të Mervan Bejtullahut dhe ndihmësve të tij, atëherë kemi plotësisht të drejtë të mendojmë se ky veprim ka qenë i nxitur dhe i stimuluar edhe nga këto organe, respektivisht nga struktura të FFK-së", thuhet në reagimin e skuadrës nga Gjakova.

Në këtë reagim skuadra e Vëllaznimit ka kërkuar edhe hetim nga organet e hetuesisë në mënyrë që të zbulohet e vërteta rreth kësaj ndeshje. "Jemi plotësisht të bindur se këtu ka punë për organet e hetuesisë. Prandaj, publikisht, i ftojme hetuesit shtetërorë që të hetojnë se nga kush kanë qenë të nxitur, të stimuluar dhe të mbrojtur gjyqtarët e kësaj ndeshje për ta bërë këtë krim sportiv. Në të kundërtën, Vëllaznimi do të jetë vetëm viktima e radhës, sepse 'fatin' e tij shumë shpejt do ta pësojnë klube të tjera dhe kështu, për rezultatet e ndeshjeve, fatkeqësisht, përcaktuese do të bëhet 'mafia e futbollit!', përfundon reagimi i Vëllaznimit.

Daku: Presim rezultate pozitive ndaj Andorrës dhe Turqisë

Prishtinë, 2 qershor - Sulmuesi i Përfaqësueses U21 të Kosovës në futboll, Mirlind Daku, është optimist se U21-shat mund të marrin rezultate pozitive në kualifikueset për Evropianin "Euro 2021" ndaj Andorrës dhe Turqisë. "Stërvitjet po shkojnë mirë dhe gjithçka është në rregull. Trajnerët janë duke punuar maksimalisht, kështu që jemi të kënaqur deri më tani. Konkurrenca është e madhe, por sidomos për futbollistët konkurrenca është shumë e mirë, pasi e shton edhe më shumë cilësinë në ekip. Thënë të drejtën, në çdo lojë hyjmë për rezultat pozitiv. Tash duam të mos humbasim, por që vjen fitorja e mirëpresim, kurse besoj se në këto dy ndeshje do të nxjerrim rezultate pozitive", ka thënë Daku.

Kosova, me simbole shtetërore në Spanjë

PRISHTINË, 2 QERSHOR - Kryetari i Federatës së Hendbollit të Kosovës, Eugen Saraçini, është takuar me presidentin e IHF-së, Hassan Moustafa dhe me përfaqësuesit e Federatës së

Hendbollit të Spanjës. Në këto takime Saraçini i është konfirmuar se flamuri i shtetit të Kosovës dhe himni i Kosovës do të respektohen gjatë Kampionatit Botëror të Juniorëve që në muajin

korrik mbahet në Spanjë. Në këtë botëror merr pjesë edhe Kosova, ndërsa autoritetet spanjolle nuk e kishin shfaqur flamurin e Kosovës në ceremoninë e shortit, duke e zëvendësuar atë me logo të FHK-së.

"Ky konfirmim erdhi pas një komunikimi të gjatë të FHK-së me IHF-në dhe Federatën spanjolle. IHF-ja, njëjtë si Federata jonë, ishte kategorike që Kosova të paraqitet e barabartë me vendet e

tjera, pra që të respektohen të gjitha simbolet tona. Kështu, Spanjës nuk iu la rrugëdalje, po ta pranojë paraqitjen tonë me të gjitha simbolet", thuhet në njoftimin e FHK-së.

Liverpooli, kampion për herë të gjashtë, Shaqiri për herë të dytë

MADRID, 2 QERSHOR - Skuadra e Liverpooli rikthehet në majën e futbollit evropian, pasi mposhti në finalen e Ligës së Kampionëve, Tottenhamin (0-2). Një gol në minutën e dytë nga penalltia i realizuar nga Salah dhe një tjetër në fund të takimit nga Origi ua kanë dhënë fitoren

"redsave" që e festuan trofeun e gjashtë të Ligës së Kampionëve, duke u ngjitur në vendin e tretë, pas Realit me 13 dhe Milanit me 7 trofe, e duke lënë Bayern Munchenin dhe Barcelonën në kuotën e pesë kupave. Një tjetër fakt interesant është se triumfues në këtë finale ishte

edhe futbollisti shqiptar Xherdan Shaqiri, i cili, pavarësisht që nuk luajti asnjë minutë, arriti ta ngrehë trofeun më të vlefshëm në futboll për herë të dytë në karrierën e tij. Në këtë mënyrë Shaqiri bëhet shqiptari i parë që fiton dy herë Ligën e Kampionëve.



Cana: Kombëtarja mund të japë edhe më shumë

TIRANË, 2 QERSHOR - Në prag të dy ndeshjeve të radhës eliminatorie për Evropianin e vitit 2020, Lorik Cana, ish-kapiteni i kombëtares kuqezi, në një intervistë për "Ora e Tiranës" ka folur për gjendjen aktuale të kuqezinjve dhe ka vlerësuar trajnerin e ri të Shqipërisë, Edi Reja. "Kjo kombëtare mund të japë akoma më shumë. Është një pjesë e lojtarëve, që mund të them kocka, ajo ekzistuese, dhe mund t'i marrim akoma më shumë. Ka përvojë dhe shpresojmë që në të ardhmen të jetë e suksesshme. Do të jetë ndoshta në vështirësi pas ca vitesh pasi të mbarojë generata e evropianit, ndoshta do të çalojë, por ende mund të na japë kënaqësi dhe krenari për disa vjet", ka thënë Cana, i cili ka folur edhe për trajnerin e ri të kombëtares Edi Reja. "Është një nga trajnerët që ka më shumë përvojë në Itali dhe në mbarë kontinentin tonë. Nuk ka përvojë jashtë Italisë përveçse te Hajduku i Splitit, por ka aq përvojë sa t'i marrë më të mirën grupit. Nëse djemtë arrijnë ta ndjekin dhe cilësitë e tyre dhe të trajnerit dalin, besoj se për një kohë të shkurtër mund të bëjmë



gjëra shumë të mira", ka shtuar Cana.

Sipas ish-mesfushorit, kombëtarja duhet t'i marrë së paku katër pikë nga dy sfidat e radhës, më datën 8 qershor kundër Islandës dhe më datën 11 qershor kundër Moldavisë. "Unë besoj se nuk kemi filluar në mënyrën më të mirë, sepse humbja me Turqinë na lë mbropa me një konkurrent për vendin e dytë. Franca do të dominojë në grup. Përveç kampion bote, ka cilësi më shumë se të tjerat. Megjithatë, Turqinë dhe Islandën nuk i kemi shumë larg nivelit tonë. Humbja me Turqinë

na ka prishur punë në garë. E kryem detyrën në Andorra dhe tani janë përballë me kundërshtarët që, së paku, jashtë fushës së tyre, në Islandë është shumë vështirë për çdo kundërshtar, mirë do të ishte të kthehemi të paktën me 1 pikë, që është komplet e realizueshme se nuk ka shumë dallime dhe ta kryejmë detyrën me Moldavinë. Trajneri Reja tha se do të kishte firmosur për katër pikë. Edhe unë do të kisha firmosur për katër ditë. Çunat e dinë që kanë për detyrë të fitojnë me Moldavinë, po edhe kjo me Islandën ka rëndësi", përfundoi Lorik Cana.

Andy Ruiz Jr shkatërron perandorinë e Joshuas

NJU JORK, 2 QERSHOR - Boksieri 29-vjeçar meksikan Andy Ruiz Jr ka tronditur botën e sportit, duke mundur kampionin e botës të peshës së rëndë Anthony Joshua me "KO teknik" në raundin e shtatë. Kjo është hera e parë në historinë e këtij sporti që një meksikan bëhet kampion bote në këtë divizion, me Ruiz Jr që shkruan historinë. Dueli mes tyre u zhvillua në "Madison Square Garden" të Nju Jorkut. Debutimi i Joshuas në Amerikë ka qenë i hidhur për britanikun, pasi i kushtoi shumë, titullin kampion bote. Titujtë që nga dita e sotme i mban një meksikan janë 33 fitore e 1 humbje për Andy Ruiz Jr në karrierë. Joshua nuk arriti për asnjë çast t'i tregojë aftësitë e tij, duke i humbur të shtatë raundet, deri kur gjyqtari ndali duelin. Për britanikun kjo është humbja e parë në karrierë, duke humbur edhe titujt e kategorive WBA, WBO dhe IBF (ka edhe 22 fitore). Në raundin e



shtatë ndodhi befasia e madhe, me Joshuan që ra në tapet për të katërtën herë dhe, pas numërimit, gjyqtari ndali duelin. Tashmë

për dy boksierët po projektetohet revanshi, sipas kontratës, që me shumë gjasa do të zhvillohet në gjysmën e dytë të këtij viti.

SHKURT

Muriqi: Dua të luaj për Galatasarayn

Reprezentuesi i Kosovës në futboll, Vedat Muriqi, për mediet turke ka konfirmuar se dëshiron të luajë për Galatasarayn. Muriqi ka shkëlqyer në edicionin e fundit me Rizesporin, duke shënuar 17 gola. "Gjyshi im ishte tifoz i Fenerbahçes, por kjo nuk do të thotë se unë e simpatizoj atë. Unë dua të luaj për Galatasarayn", ka thënë Muriqi për "Milliyet".

Greza: Kjo është arsyeja e largimit nga kombëtarja

Eros Greza ka lënë të shtunën grumbullimin me kombëtaren e Shqipërisë dhe nuk do të jetë i gatshëm për dy sfidat e radhës kualifikuese ndaj Islandës dhe Moldavisë. Gazeta "Panorama Sport" e ka kontaktuar vetë futbollistin gjakovar në lidhje me shkakun e këtij largimi. "Kam një problem në aduktorë. Dëmtim për të cilin rrezikoj shumë nëse vazhdoj stërvitjen". Më tej, në rrjetet sociale, vetë mesfushori me tipare të avancuara ka bërë një urim për shokët e skuadrës, teksa në të njëjtën kohë ka shprehur keqardhjen që nuk do të jetë në dispozicion të ekipit kombëtar", ka thënë Greza.

Van Dijki: Messi e meriton 'Topin e Artë'

Pasi ka fituar Ligën e Kampionëve dhe është zgjedhur lojtari më i mirë i finales, lojtari i vitit në Premier Ligë, Virgil Van Dijk, po shihet si kandidat serioz edhe për "Topin e Artë". Megjithatë, mbrojtësi holandez nuk e mendon një gjë të tillë, pasi beson se Leo Messi është favorit për ta fituar "Topin e Artë". "Mendoj se Lionel Messi është lojtari më i mirë në botë. Mendoj se ai e meriton 'Topin e Artë' për sa kohë do të luajë futboll, ndaj ky çmim nuk është diçka që e kam në mendje. Natyrisht, nëse ndodh do ta pranoj, por nuk mendoj se do të ndodhë. Jam i bindur që Messi është ende numri një në botë. Nuk ka rëndësi nëse shkon apo jo në finalen e Ligës së Kampionëve", ka thënë Van Dijk.

Petrucci triumfon në Mugello

Në Mugello feston Ducati. Fitore e madhe e Danilo Petruccit në garën e shtëpisë me pilotin italian të Ducatit që regjistroi suksesin e parë sezonal në një garë vërtet spektakolare siç ishte ajo e Mugellos. Një duel 3-sh nga filimi deri në fund mes Petruccit, Marquez dhe Dovizioso. Pasi fitoi nga i pari i cili përfitoi nga një kontakt në xhiron e fundit mes dy rivalëve për titull, Marquez dhe Dovizioso, duke i parakaluar të dy për ta marrë kreun të cilin e kishte mbajtur për pjesën më të madhe të xhirove. Pikërisht Marquez dhe Dovi kompletuan dy shkallët më të ulëta të podiumit, ndërkohë që surpriza e këtij sezoni Alex Rins u kënaq me vendin e 4-t. Garë e dështuar për Valentino Rossin që e nisi nga vendi i 18 dhe u rrëzua kur kishte kaluar gjysmën e xhirove. Megjithatë nga triumfi i Danilo Petruccit përfitoi Marquez që me vendin e dytë e thelloi në 12 pikë avantazhin në klasifikimin e përgjithshëm ndaj ndjekësit më të afërt Andrea Dovizioso.

Arsenali e merr vendimin për Ozilin

